



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

“Ky projekt/aktivitet është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicërene për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicërene për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizata Jo - Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

Studim mbi qëndrimet,
sjelljet dhe perceptimet e qytetarëve
të Prizrenit mbi kulturën dhe artin –
një bazë legjitime për ndërtimin e
politikave kulturore në Prizren

Autor: Aliriza Arënliu Organizata:
EC Ma Ndryshe Prill 2013

Përmbajtja

Hyrje	3
Sfondi	3
Struktura menaxhuese e kulturës në Prizren	4
Sektori i pavarur i kulturës në Prizren.....	4
Dokumente të tjera relevante	4
Studimi mbi qëndrimet, sjelljet dhe perceptimet e qytetarëve të Prizrenit mbi kulturën dhe artin	4
Përzgjedhja e mostrës.....	4
Përshkrimi i mostrës	5
Studimi me organizatat kulturore në Prizren ..	13
Rezultatet.....	13
Burimet njerëzore në organizata	13
Logjistika dhe infrastruktura e organizatave.....	13
Aktivitetet e organizuara, financimi dhe pjesëmarrja në proceset për politika lokale kulturore	15
Përmbledhje nga diskutimet publike	17
Konkluzionet dhe diskutimi.....	19
Diskutim	21
Limitimet e studimit.....	22

Hyrje

Ky studim përfshin raportin e studimit (hulumtimit) të bërë nga OJQ EC Ma Ndryshe me 500 banorë të qytetit të Prizrenit dhe rezultatet e 23 intervistave të strukturuar me organizata të përfshira në aktivitete kulturore në Prizren dhe nga përmbledhja e 4 diskutimeve të ndryshme të organizuara me akterë relevantë në fushën e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore. Raporti tenton të analizojë të dhënat nga këto tre burime të dhënave, në mënyrë të veçantë, dhe në fund të tentojë të nxjerr përfundime dhe të jap rekomandime për hapa të ardhshëm në fushën e kulturës në Prizren. Qëllimi i raportit është njëkohësisht të tentojë që t'i jap udhëzimet themelore për zhvillimin e politikave kulturore në qytet, duke u bazuar në të dhënat dhe rezultatet e këtij hulumtimi. Kjo është tentativa e parë e këtij lloji, që përdor një metodë gjithëpërfshirëse të grumbullimit të dhënave për një kulturë dhe çështjet e ndërlidhura me sektorin e kulturës në qytetin e Prizrenit.

Sfondi

Prizreni, shpesh përmendet si kryeqytet i kulturës, por duket se kjo është një klishe pasi që një epitete i tillë do të kërkonte edhe një argumentim se cilat do të ishin arsyet që e bëjnë kryeqytet të kulturës. Argumentet nuk qëndrojnë pasi që qyteti në nivelin politik nuk ka një politikë të caktuar kulturore dhe skena kulturore karakterizohet me ngjarje që kryesisht apo kryekëput organizohen nga organizata të pavarura kulturore të cilat kryesisht sponsorimin/financimin e aktiviteteve kulturore e realizojnë me ndihmë modeste nga autoritet komunale dhe atyre qendrore.

Përkundër asaj se Prizreni nuk është kryeqytet i kulturës në Kosovë, skena e saj kulturore është e pasur në krahasim me qytetet e tjera në Kosovë. Kjo kryesisht është për shkak të angazhimit dhe përkushtimit të organizatave dhe shoqatave të pavarura që organizojnë aktivitete të rregullta kulturore në qytet. Fatkeqësisht skena kulturore në qytet është reduktuar në festivale dhe manifestime jubilarë, të cilat organizohen një herë në vit ndërsa ka mungesë të aktiviteteve të rregullta kulturore si teatër, kinema apo ekspozita të rregullta. Kjo e fundit ndodh për dy arsye: e para është se vetë komuna apo institucionet përkatëse nuk kanë një plan në këtë drejtim dhe e dyta se ka mungesë të infrastrukturës dhe buxhetit për zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

Një nga konstatimet e mundshme është se organet komunale kanë një politikë kulturore e cila përkufizohet kështu: “të mos kemi politikë kulturore”, e cila mundëson financime ad-hoc të aktiviteteve kulturore, pa ndonjë planifikim afatgjatë të aktiviteteve kulturore që do të adresonte nevojën e qytetarëve të Prizrenit dhe do ta zhvillonte edhe më shumë skenën kulturore.

Ky studim është tentativa e parë në procesin e zhvillimit të politikave kulturore në qytetin e Prizrenit, duke përfshirë qytetarët e Prizrenit dhe matur sjelljen e tyre në lidhje me aktivitetet kulturore, qëndrimet e tyre ndaj kulturës në përgjithësi përfshirë edhe qëndrimet ndaj organeve komunale në raport me aktivitetet kulturore. Studimi analizon edhe kapacitetet e organizatave kulturore në qytetin e Prizrenit, të cilat mbështeten bartës të rëndësishëm të zhvillimit të aktiviteteve kulturore në Prizren dhe në Kosovë. Përpos këtyre të dhënave raporti përfshin edhe

konkluzionet kryesore nga 4 diskutime të mbajtura ku u diskutua për: politikat kulturore; financimin e aktiviteteve kulturore; prezantimin e të dhënave fillestare nga hulumtimi me qytetarë; dhe organizatat kulturore dhe kultura në programet e partive politike.

Struktura menaxhuese e kulturës në Prizren

Në kuadër të Komunës së Prizrenit kultura bie nën përgjegjësinë e Drejtorisë për Kulturë, Sport dhe Rini. Kjo drejtori numëron 22 punonjës. Buxheti i ndarë për këtë drejtori në vitin 2012 ka qenë 1.364.220,00 euro, nga të cilat 115.000,00 kanë qenë për subvencione gjegjësisht për sponsorim dhe përkrahje të ngjarjeve kulturore. Tradicionalisht, që nga themelimi i strukturave me IPVQ në komuna dhe nga pavarësimi i vendit në vitin 2008, Drejtoria për Kulturë është udhëhequr nga partitë minoritare që kanë pasur ndikim të vogël politik qoftë në prezantimin e planeve të punës apo në miratimin e buxhetit vjetor për kulturë.

Spektori i pavarur i kulturës në Prizren

Organizatat e pavarura të kulturës në Prizren, që nga korriku i vitit 2012 janë të organizuara në një platformë jo-formale që quhet “Rrjeti i organizatave kulturore në Prizren” me shkurtesën RROK. Kjo platformë numëron 23 anëtarë.¹ Ky është rrjeti joformal i organizatave dhe aktivistëve të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe sasisë së

aktiviteteve kulturore. Objektivat themelore të punës së Rrjetit në Prizren përfshijnë: pasurimin e jetës kulturore, ngritjen e cilësisë së aktiviteteve ekzistuese kulturore, strukturimin e ofertës kulturistike, përmirësimin e politikave kulturore në nivel komunal, menaxhimin e decentralizuar të kulturës, diversifikimin e financimit të aktiviteteve kulturore dhe nxitjen e qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme.

Dokumente të tjera relevante

Rishtazi komuna ka aprovuar një udhërrëfyes mbi zhvillimin e politikave kulturore në qytetin e Prizrenit, që është punuar nga Teatri Oda në bashkëpunim me organet komunale të qytetit të Prizrenit.

Studimi mbi qëndrimet, sjelljet dhe perceptimet e qytetarëve të Prizrenit mbi kulturën dhe artin

Përzgjedhja e mostrës

Pasi që janë përzgjedhur 18 vendnumërimet në Prizren mostra e synuar prej 500 respondentëve është shpërndarë në mënyrë të barabartë në secilin vendnumërim. Respondentët janë përzgjedhur me metodën e rastit, duke përzgjedhur në mënyrë të rastësishme çdo shtëpi të katërt. Në rastet e refuzimit, anketuesit kanë tentuar në shtëpinë e ardhshme.

¹ Rrjeti i organizatave kulturore në Prizren – RROK, <http://www.rrok-pz.net/?page=1,3>

Përshkrimi i mostrës

Shumica e mostrës së intervistuar kanë qenë femra 60% dhe 40% meshkuj². Moshë mesatare e respondentëve ka qenë 35.6, me moshën më të re prej 16 dhe më të vjetër prej 88 vjeç. Moshë mesatare e meshkujve ka qenë 35.4 dhe për femra 35.8.

Figura 1 paraqet etninë e respondentëve, me ç'rast 88% kanë qenë shqiptarë, 5.2% turq, 3.6% RAE, 3% boshnjakë dhe 0.2% serbë.

Figura 1 – Etnia e respondentëve





Tabela 2 paraqet nivelin e edukimit të respondentëve të hulumtimit respektivisht nivelin e fundit të përfunduar. Shumica e respondentëve janë me shkollë të mesme 33.5% gjersa 13.4% e mostrës së intervistuar kanë të mbaruar studimet universitare.

² Një nga shpjegimet se pse kemi numër më të madh të femrave në mostër mund të jetë prezencë në shtëpi dhe tjetra se meshkujt gjinden me punë në vende të jashtme dhe në përzgjedhjet e mostrës me ditëlindje familjet nuk i kanë llogaritur anëtarët që punojnë dhe jetojnë jashtë vendit.

Tabela 2 – Niveli i edukimit të respondentëve (përfunduar)



Sa i përket religjionit, 97.2% i takojnë konfesionit islam, 2.6% atij katolik dhe 0.2% janë deklaruar si ateist.

Grafikoni 2 – Përkatësia fetare e respondentëve




Tabela 3 paraqet përqindjen e të punësuarve, të papunëve që kërkojnë punë dhe që nuk kërkojnë punë si dhe kategoritë e tjera. Nga kjo shihet se 38% të respondentëve janë të punësuar, gjersa një numër i konsiderueshëm i mostrës 28.1% janë të papunë dhe nuk kërkojnë punë.

Tabela 3 – Statusi i punësimit të respondentëve






Figura 4 paraqet përqindjen e respondentëve që janë përgjigjur me po nëse organizatat kulturore, rinore, të drejtave të njeriut, bamirëse, sindikatat dhe organizatat të tjera kanë pasur ndikim pozitiv në 5 vitet e fundit në vendin ku jetojnë ata. Përqindje më të lartë kanë shënuar organizatat bamirëse me 50.5% derisa organizatat kulturore, të muzikës dhe të arsimit janë renditur në pozitën e katërt, me përafërsisht 35% të respondentëve që mendojnë se ato kanë pasur ndikim pozitiv në rrethin e tyre.

Figura 4 – Ndikimi pozitiv i organizatave në 5 vitet e fundit sipas respondentëve




Pyetjet në vijim tregojnë rezultatet e përgjigjeve për angazhimin e qytetarëve në organizata të ndryshme apo shoqëri civile dhe forma të ndryshme të aktiviteteve artistike në të cilat ata janë apo kanë qenë aktiv. Në pyetjen, sa shpesh merreni me ose kaloni kohë me njerëz në klube sportive apo në organizata vullnetare apo organizata të shërbimit, Figura 5 tregon se 78% të respondentëve janë përgjigjur “asnjëherë” për derisa pjesa tjetër e respondentëve kanë deklaruar se janë aktivë, por me shpeshtësi të ndryshme, ku vetëm 10.2% të tyre janë aktivë çdo javë.

Figura 5 – Shpeshtësia e pjesëmarrjes në klube sportive, organizata vullnetare apo të shërbimeve të tjera



Në pyetjet nëse qytetarët shkruajnë poezi, luajnë në ndonjë instrument apo janë pjesëtarë të ndonjë kori, teatri apo OJQ-je Figura 6 paraqet rezultatet vetëm të qytetarëve që janë përgjigjur se janë marrë me dhe të atyre që ende janë aktiv në fushat e shtruara në pyetje. Përqindja më e lartë e qytetarëve të intervistuar duket se ende merren me poezi 5.4% ose luajnë në ndonjë instrument muzikor 4.8% derisa vetëm 2.2% të tyre janë aktiv në kor, ansambël ose në teatër. Nga këto rezultate, 12.4% të popullatës ende merren me aktivitete që janë të ndërlidhura me kulturë me shpeshtësi të ndryshme gjatë tërë vitit.

Figura 6 – Përqindja e respondentëve që janë marrë apo merren me poezi, muzikë (ekzekutojnë në instrument ende) dhe anëtarë të ansamblit, korit ose teatrit




Sjellja e respondentëve në raport me aktivitetet kulturore

Ky seksion i rezultateve prezanton rezultatet në lidhje me konsumin e aktiviteteve kulturore nga ana e qytetarëve të Prizrenit. Pjesa e parë prezanton rezultatet e shkarkimit të produkteve kulturore prej internetit dhe pjesa tjetër përqindjen e qytetarëve që kanë vizituar aktivitete të ndryshme kulturore në 12 muajt e fundit, përfshirë edhe vizitën në lokacionet arkeologjike të qytetit të Prizrenit.

Një pyetje e veçantë ka matur sjelljen e respondentëve në lidhje me konsumin e produkteve kulturore nga interneti. 54.5% të popullatës kanë deklaruar se kanë përdorur internetin për shkarkim të filmave, muzikës apo librave. Nga popullata e përgjithshme e hulumtimit 45.9% kanë përdorur internetin për shkarkim të muzikës, 33.9% kanë shkarkuar filma dhe 13.6% kanë shkarkuar libra.


Figura 7 - Sjellja në lidhje me pjesëmarrjet në aktivitete kulturore (12 muajt e fundit në Prizren)



Vizita në lokacione arkeologjike (Kalaja, Lidhja e Prizrenit, etj.) ka dal të jetë me përqindje më të lartë (72.7%), e pasuar nga koncerte në shesh me 69.5%, me festival të filmit 40.10%, koncerte në lokale 34.3%, teatër 28.7% dhe kështu me radhë. Figura 7 paraqet përqindjet në bazë të aktivitetit kulturor. Në përgjithësi, përqindjet janë relativisht të larta posaçërisht për aktivitete të cilat nuk kërkojnë pagesë (këtu përfshihet edhe kinemaja e hapur në lumë gjatë Dokufestit).

Figura 8 paraqet dallimet gjinore në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme kulturore dhe në përgjithësi mund të vërehet se meshkujt raportojnë vizita me përqindje më të lartë në krahasim me femrat në të gjitha aktivitetet përpos teatrit.

Figura 8 - Sjellja në lidhje me pjesëmarrjet në aktivitete kulturore (12 muajt e fundit në Prizren) – dallimet gjinore




Qëndrimet dhe perceptimet ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore

Kjo pjesë e rezultateve prezanton qëndrimet dhe perceptimet e qytetarëve të Prizrenit ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore. Perceptimet janë matur duke pyetur qytetarët nëse mendojnë se qyteti i Prizrenit ka më shumë aktivitete kulturore në krahasim me qytete të tjera. Qëndrimet janë matur me pyetjet e tipit *"sa është e rëndësishme kultura dhe jeta kulturore në jetën time personale?"*, faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje apo mospjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe 13 pyetje të deklaratave, të cilat masin qëndrimet ndaj kulturës në përgjithësi, si për shembull: *"Të gjithë fëmijët në shkollë duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në aktivitete kulturore"*, *"Pjesëmarrja në aktivitete artistike e bën personin të ndihet më mirë"*


për veten e vetë." Nga këto 13 pyetje është krijuar një indeks me minimum prej 13 pikëve (që do të ishte indikator i qëndrimeve negative ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore) deri në 52 pikë (që do të ishte indikator i qëndrimeve shumë pozitive ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore).

Figura 9 - Perceptimi i qytetarëve për numrin e aktiviteteve kulturore në Prizren në krahasim me qytetet tjera



Duket se perceptimi se Prizreni është qytet i kulturës gjen pajtueshmëri edhe në mesin e qytetarëve të Prizrenit, ku përafërsisht 74% të qytetarëve mendojnë se qyteti ka më shumë ose deri diku ka më shumë aktivitete kulturore se qytetet e tjera në Kosovë. Në anën tjetër 21.4% të qytetarëve mendojnë se Prizreni ka më pak aktivitete kulturore se qytetet e tjera në Kosovë. Kur analiza bëhet sipas grupmoshave rezulton se të rinjtë të moshës 16-25 vjeç në përgjithësi raportojnë me përqindje më të ultë se në Prizren ka më shumë aktivitete kulturore në krahasim me qytetet e tjera në Kosovë. Përqindjet janë të prezantuara në figurën 10.

Figura 10 - Perceptimi në pyetjen se Prizreni ka më shumë aktivitete kulturore në krahasim me qytetet tjera në Kosovë, përqindja sipas grup moshave




Një pyetje tjetër ka tentuar të mat se sa janë të kënaqur qytetarët e Prizrenit me jetën kulturore në Prizren, me ç'rast me 1 është vlerësuar si shumë të pakënaqur dhe me 8 si shumë të kënaqur. Mesatarja e përgjithshme për popullatën ka rezultuar me 5.02 pikë nga 8 pikët maksimale.

Në pyetjen nëse jeta kulturore dhe aktivitetet kulturore janë të rëndësishme në jetën e qytetarëve të Prizrenit, shumica dërmuese e respondentëve pa dallim në grup moshë deklaruan se ajo është e rëndësishme. Më saktësisht 67.6% kanë deklaruar se është shumë e rëndësishme, 25.2% kanë deklaruar se është mesatarisht e rëndësishme, 5.2% jo aq e rëndësishme dhe 2% aspak e rëndësishme. Nga kjo mund të nxirret përfundimi se kultura dhe aktivitetet kulturore janë të rëndësishme në jetën e qytetarëve të Prizrenit.

Në pyetjen se "Cilat janë faktorët që ndikojnë në vendimin tuaj për të marrë pjesë në një aktivitet kulturor?", janë përmendur katër arsye kryesore me këtë radhitje: 47.3% deklaruan se qëllimi është të kënaqen me familjen apo shoqërinë, 20.5% të jetë e argëtueshme, 12.6% të jetë interesante, 4.2% të jenë në gjendje ta

mbulojnë financiarisht dhe 4.7% të jetë në përputhje me vlerat tradicionale. Figura 11 paraqet përqindjen e arsyeve të dhëna nga respondentët që ndikojnë në përzgjedhjen dhe vendimin për të vizituar një aktivitet kulturor.

Figura 11- Arsyet që ndikojnë për të vizituar një ngjarje kulturore



Një pyetje e ngjashme është shtruar për të kuptuar se cilat janë arsyet kryesore për mos pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet kulturore. Figura 12 tregon përqindjet për arsyet e dhëna, ku mungesa e kohës është përmendur si arsye kryesore nga 45.3% të respondentëve, pasuar nga janë të shtrenjta 15%, nuk kam interesim 14.2%, 10.2% nuk kanë informatë se çka është duke ndodhur, 8.4% nuk ka kualitet në jetën kulturore, 4% nuk përshtaten me vlerat dhe zakonet e mia dhe me 1.6% se nuk kanë prapavijë kulturore.

Figura 12 - Arsyet që ndikojnë për të mos marrë pjesë në aktivitetet kulturore



Qëndrimet ndaj kulturës në hulumtim janë matur gjithashtu me 13 deklarata të ndryshme ku nga respondentët është kërkuar pajtimi ose mos pajtimi për deklaratat në fjalë. Nga përgjigjet e respondentëve është krijuar një indeks për qëndrimet ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore, që ka rezultuar nga 13 pikë minimale deri në 52 pikë maksimale për secilin respondentë. Tabela 1 paraqet mesataret e indeksit të qëndrimeve ndaj kulturës për gjini dhe grup moshë të ndryshme.


Tabela 1 - Mesatarja e indeksit të qëndrimeve ndaj kulturës sipas grup moshave

Kategoria	Mesatarja e indeksit
Meshkuj	42.81, DS=4.2
Femra	41.03, DS=4.1
16-25 vjet	42.28, DS=4.3
26-35 vjet	41.87, DS=4.2
36-49 vjet	41.23, DS=4.1
Mbi 50 vjet	41.24, DS=4.3

Siç mund të vërehet nga tabela e mësipërme në përgjithësi mesataret janë të larta dhe nuk ka dallime domethënëse në mes të gjinive dhe grup-moshave të ndryshme. Krahasimet edhe për nga punësimi, të qenit fetar apo jo, nivelit të edukimit kanë rezultuar me mesatare të ngjashme dhe pa dallime domethënëse në mesataren e qëndrimeve ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore. Nga këto rezultate mund të nxirret përfundimi se kultura dhe aktivitetet kulturore janë të rëndësishme në jetën e qytetarëve të Prizrenit.


Një pyetje është veçuar nga këto qëndrime, ku qytetarët janë pyetur nëse komuna duhet të ndajë më shumë mjete për aktivitetet kulturore, me ç'rast shumica dërmuese e respondentëve janë pajtuar apo fuqimisht janë pajtuar me këtë deklaratë.

Figura 13 - Komuna duhet të ndajë më shumë mjete për aktivitete kulturore



Hulumtimi gjithashtu ka pyetur respondentët për preferencat e tyre në lidhje me aktivitetet kulturore që duhet t'i ketë qyteti. Nga respondentët është kërkuar që të rendisin 3 aktivitete që mendojnë se janë të rëndësishme për ata. Në renditjen e parë 4 aktivitetet e para janë paraqitur në Figurën 14. Kinemaja që punon çdo ditë ka rezultuar që të jetë më e dëshiruara nga 60.6% të respondentëve.

Figura 14 - Renditja e parë për aktivitetet kulturore më të dëshiruara nga respondentët



Renditja e dytë me 3 aktivitete më të kërkuara nga respondentët është paraqitur në Figurën 15 ku shfaqje të shpeshta për fëmijë ka rezultuar që të jetë më e larta, e pasuar nga shfaqje të përditshme të teatrit.

Figura 15 - Renditja e dytë për aktivitetet kulturore më të dëshiruara nga respondentët



Renditja e tretë me 5 aktivitete më të kërkuara nga respondentët është paraqitur në Figurën 16, ku më shumë festivale të ndryshme ka rezultuar të jetë më e kërkuara me 28.9%, e pasuar me më shumë koncerte të muzikës zbavitëse 19.7%.

Figura 16 - Renditja e tretë për aktivitetet kulturore më të dëshiruara nga respondentët




Nga kjo rezulton se renditja 1 është: kinema që punon çdo ditë, renditja 2: shfaqje më të shpeshta për fëmijë dhe renditja 3: më shumë festivale të ndryshme.

Informimi në lidhje me organizimin e ngjarjeve kulturore

Një pyetje është përqendruar në atë se nga cilat burime i marrin informatat qytetarët e Prizrenit në lidhje me aktivitetet kulturore. Analiza ka rezultuar se përafërsisht 48.2% e respondentëve janë informuar nga televizioni, pasuar nga miqtë dhe të afërmit 21.8%, pasuar me përqindje më të vogla për burime të tjera të informimit të cilat janë në figurën 17.

Figura 17 - Nga cili burim informoheni më së shumti mbi aktivitetet kulturore në qytetin e Prizrenit?



Studimi me organizatat kulturore në Prizren

Hulumtimi është zhvilluar me 23 organizata (shih aneksin 2 për listën e organizatave) që veprojnë në Prizren dhe që janë të përfshirë në forma të ndryshme në jetën kulturore të qytetit të Prizrenit. Pyetësi me përafërsisht 40 pyetje është plotësuar nga personat kompetentë në këto organizata. Pyetësi përmban pyetje të ndryshme të cilat kanë grumbulluar të dhëna të përgjithshme për organizatën si profilin e organizatës, infrastrukturën dhe logjistikën, bashkëpunimin rajonal, vendor dhe në qytet, për aktivitetet kulturore të organizuara, sistemin e punës në organizata dhe mënyrat e financimit të aktiviteteve.

Rezultatet

Sa i përket fushës së organizatave të përfshira në hulumtim janë të shumta dhe të ndryshme. Organizatat merren me trashëgimi kulturore, organizim të aktiviteteve kulturore, muzikë popullore, film, muzikë, strip, pikturë, folklor, mbrojtjen e kulturës dhe gjuhës së minoritarëve, teatër etj.

Burimet njerëzore në organizata

Në pyetjen se sa anëtarë aktiv kanë organizatat e intervistuar, përgjigjet kanë ndryshuar nga 1 deri në 90 anëtarë aktiv, me një mesatare prej 13.9 anëtarëve aktiv. Numri maksimal i femrave aktive me një organizatë ka qenë 20 gjersa për meshkuj 90. Mesatarja e anëtarëve meshkuj është më i lartë 19.57 në krahasim me atë të femrave 11.99.

Numri total i të punësuarve në 23 organizata është 32 persona nga të cilët 22 janë meshkuj dhe 10 femra. Në përgjithësi

rezulton me një nivel të ultë të mesatares të punësuarve për organizatë gjegjësisht 1.32 për një organizatë. Organizatat e intervistuar kanë raportuar se kanë nga 10 deri në 700 vullnetarë, që në mesatare i bie 63.9 vullnetarë për organizatë, që është një numër relativisht i lartë.

Sa i përket numrit të punëtorëve të aftësuar për aktivitete apo detyra specifike rezultojnë që organizatat qëndrojnë jo edhe aq mirë. Figura 18 prezanton mesataret ku për pozita të rëndësishme si financa dhe administratë janë 0.3 persona për një organizatë, 1.1 punëtorë të aftësuar për raportim me shkrim dhe 1.3 punëtorë që janë të aftë në përpilim të projekt-propozimeve. Më saktësisht 10 organizata nuk kanë punonjës të trajnuar për çështjet financiare dhe administrative.

Figura 18 - Mesatarja e punëtorëve me shkathtësi të caktuara



Logjistika dhe infrastruktura e organizatave

Tabela 2 paraqet përqindjen e organizatave që kanë zyrë e që janë 86.4% apo 19 organizata, prej të cilave 63.2% apo 12 organizata paguajnë qera derisa 7 prej tyre nuk paguajnë qera. 21.1% të organizatave të intervistuar kanë deklaruar se kanë hapësirë për programe artistike. Sa i përket pyetjes për atë se sa metra katrorë i kanë zyrat, zyra më e vogël e raportuar ka qenë

prej 10 metra katrorë dhe më e madhja prej 170 metra katrorë. Mesatarja për të gjitha organizatat është 63.9 metra katrorë.

Tabela 2 - Organizatat dhe hapësirat për zyre dhe aktivitet kulturore

	Po	Jo
A keni zyre të juaja	86.4%	13.6%
A i keni me qira	63.2%	36.8%
A keni hapësirë për programe artistike	21.1%	78.9%

Nëse marrim statistikën prej 13.9 anëtarëve aktiv, atëherë i bie se një anëtar në mesatare ka 4.6 metra katrorë hapësirë pune. Mesatarja e qerasë mujore ka rezultuar të jetë 145 euro, me qira minimale prej 7 deri në 300 euro maksimale. Me këtë mesatare i bie se organizatat kulturore paguajnë përafërsisht 40.020 euro qera në vjet.

Tabela 3 - Pajisjet dhe burimet teknike të organizatave të intervistuar


	Po	Jo	Numri minimal dhe maksimal i pajisjes
Kompjuterë	73.9 %	26.1%	1-13
Shtypës	52.2%	47.8%	1-4
Telefoni fikse	34.8%	65.2%	1
Fotokopje	30.4%	69.6%	1-2
Zërim	30.4%	69.6%	1-2
Zmadhues	30.4%	69.6%	1
Mikrofon	26.1%	73.9%	1-10
Kamerë	17.4 %	82.6%	1-5
LCD projektor	34.8%	65.2%	1-4
Ndriçim profesional	13%	87%	1
Automjet	13%	87%	1

Tabela e mësipërme tregon përqindjen e organizatave që kanë apo nuk kanë pajisje të caktuara.

Aktivitetet e organizuara, financimi dhe pjesëmarrja në proceset për politika lokale kulturore

Organizatat janë pyetur edhe në lidhje me aktivitete të ndryshme të organizuara dhe Figura 19 paraqet numrin dhe llojin e organizimeve, në vitet 2009, 2010 dhe 2011. Ajo që mund të vëzhgohet nga Figura e mëposhtme është se kemi rritje të numrit të aktiviteteve të të gjitha llojeve përpos festivaleve, shembull: numri i koncerteve nga 34 në vitin 2009 është rritur në 77 në vitin 2011. Ajo që mund të vërehet është numri i lartë i aktiviteteve si punëtori, konferenca dhe debate.

Figura 19 - Numri dhe lloji i aktiviteteve në mes të viteve 2009 dhe 2011



Sa i përket bashkëpunimit të organizatave kulturore në Prizren me njëra tjetrën në qytet, në Kosovë dhe në nivelin ndërkombëtar përqindje më të larta janë parë për bashkëpunimin me organizatat në qytet 87%, gjersa kemi edhe nivel të lartë të bashkëpunimit me organizatat jashtë vendit 73.9% në krahasim me organizatat në vend 66%. Sa i përket pyetjes nëse janë pjesë të organizatave rajonale 34.8% të tyre kanë pohuar se janë anëtarë.

Figura 20 - Bashkëpunimi me organizatat në qytet, vend dhe jashtë Kosovës



Organizatat janë pyetur edhe në lidhje me burimet e financimit të aktiviteteve të tyre, minimumin, maksimumin dhe mesataren e përqindjeve të financimit për secilin burim dhe ato janë paraqitur në tabelën 4. Duket se fondacionet e huaja me mesatare prej 23% ende 10 vite pas luftës mbesin financues kryesor të aktiviteteve të organizatave kulturore, pasuar nga individë me mesatare prej 9.34% dhe kompani dhe biznese vendore 8.17% dhe më pas të pasuar nga Komuna 7.3% dhe Ministria e Kulturës 6.1%. Në nivel të ultë duket të jetë gjenerimi i mjeteve vetanake apo vetë-financimit të aktiviteteve nga vetë organizatat.


Tabela 4 - Burimet e financimit, minimumi, maksimumi dhe mesatarja e përqindjeve

	Rangu i përqindjes së raportuar	Mesatarja e raportuar me përqindje
Individë	0 – 60%	9.34%
Kompani nga vendi biznese	0 – 80%	8.17%
Kompanitë publike	0-10%	0.43%
Komuna	0-50%	7.3%
Ministria e Kulturës	0-40%	6.1%
Fondacione nga vendi	0-45%	7.82%
Fondacione të huaja	0 – 80%	23%
Nga shërbimet që ju ofroni (bileta etj)	0-15	1.3%

Në pyetjen, se kush nga anëtarët e organizatës punon në sigurimin e fondeve pothuajse gjysma e organizatave të intervistuar kanë deklaruar se drejtori apo drejtoresha merret ekskluzivisht me atë punë, derisa 13% kanë thënë se këtë e bëjnë njerëzit që njohin njerëz të caktuar dhe me përqindje të njëjtë prej 21.7% të organizatave kanë thënë se kanë ekip të caktuar për ngritje të fondeve dhe se të gjithë në organizatë provojnë të sigurojnë


fonde. Figura 21 paraqet të dhënat e sipërpërmendura.

Figura 21 - Kush i siguron fondet në organizatën tuaj



Shumë pak organizata kanë raportuar se kanë marrë pjesë në procese që kanë të bëjnë me përpilimin e politikave kulturore gjegjësisht vetëm 12.9%, që kanë thënë me 4.3% mesatarisht, shpesh dhe shumë shpesh/gjithmonë. Ndërsa pothuajse gjysma e organizatave nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në procese që kanë të bëjnë me politikat kulturore në nivelin lokal.

Figura 22 - Pjesëmarrja në proceset që kanë të bëjnë me politika lokale kulturore



Përmbledhje nga diskutimet publike

Kjo pjesë përmban përmbledhjen e katër diskutimeve publike të mbajtur me përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë, përgjegjës komunal në njësi të ndryshme, parti politike, media dhe me grupe të ndryshme të interesit. Debatet publike në mesatare kanë zgjatur nga 2 orë e 30 minuta dhe kanë qenë të organizuara nga OJQ Ec ma Ndryshe.

Debati i parë është bazuar në prezantimin e rezultateve fillestare që janë pjesë përbërëse e këtij raporti mbi perceptimin e qytetarëve ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore dhe konsumit kulturor dhe vlerësimit të kapaciteteve të organizatave kulturore. Pas prezantimit të rezultateve është zhvilluar një diskutim kryesisht me përfaqësues të shoqërisë civile në Prizren. Diskutimet kryesisht mbështetën gjetjet e hulumtimit duke përfunduar se perceptimi pozitiv i qytetarëve ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore është një përkrahje e mëtutjeshme që përforcon adresimin e kulturës më seriozisht në nivelin komunal.

Gjithashtu u konstatua se preferencat e qytetarëve për aktivitete të caktuara duhet të artikulohej në çfarëdo plani apo politike kulturore për qytetin e Prizrenit. Përfaqësues të shoqërisë civile cekën se aktivitetet kulturore që organizohen nga organizatat kulturore në Prizren kryesisht kufizohen në aktivitete kulturore të muzikës, filmit dhe folklorit ndërsa kultura si koncept është më e gjerë dhe përfshin edhe shumë aspekte të tjera si trashëgiminë kulturore, kuzhinën tradicionale dhe shumë fusha të tjera që lidhen me kulturën.

Debati i dytë ishte mbi politikat e financimit të kulturës në nivelin lokal, ku morën pjesë **Znj. Vjollca Aliu** – Drejtoreshë e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në MKRS, **Z. Ruzhdi Rexha** – Nënkretar i Komunës së Prizrenit, **Z. Sali Shoshi** – Drejtor në “Trashëgimia Kulturore pa Kufij – CHwB”, **Z. Bahri Zenelaj** – OJQ “ATTA” – Prizren. Konkluzionet kryesore nga debati ishte se niveli komunal në aspektin buxhetor ka vështirësi në rritjen e buxhetit për kulturë. Në përgjithësi të gjithë pjesëmarrësit ishin të pajtimit për nevojën e një bashkëpunimi më të thellë në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe komunës për qëllim të avancimit të kulturës dhe jetës kulturore në Prizren. Përkundër thirrjeve për bashkëpunim nuk u propozua ndonjë formë konkrete e bashkëpunimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që u cek në debat ishte edhe marrja parasysh e nevojave të vendeve rurale, në rast të zhvillimit të politikave kulturore dhe jo vetëm të mjediseve jetësore të qyteteve. Po ashtu pjesëmarrësit ngritën çështjen e mungesës së vlerësimit të projekteve kulturore që financohen nga paratë publike, pasi që vlerësimi i vetëm që i bëhet është zakonisht ai financiar dhe jo cilësor, që bazohet në raportimin e faturave nga ana e

organizatorit për shpenzimet e bëra në kundërvlerë të parasë publike të marrë nga komuna. Konstatim tjetër ishte se qasja nga dy nivelet komunale dhe qendrore janë të ngjashme ndaj sektorit të pavarur kulturor që kufizohet në financim të ndërtimit të objekteve sportive dhe kulturore, financim të festivaleve dhe kjo implikon mungesë të një strategjie më të gjerë për kulturën dhe aktivitetet kulturore. Konstatim tjetër ishte se ende ekziston tendenca e lënies së kulturës në prapavijë, duke shfrytëzuar argumente se kemi sektorë të tjerë më të rëndësishëm si edukimi apo shëndetësia që përsëri përbën një qasje burokratike e aspak kreative posaçërisht nëse merret parasysh skena e pasur kulturore që ekziston në qytetin e Prizrenit. Niveli lokal duket se ende nuk e sheh kulturën si mjet të zhvillimit ekonomik, por më shumë si barrë, gjë që vjen nga qasja burokratike ndaj menaxhimit të kulturës.

Debati i tretë ishte mbi konsumin dhe ofertën kulturore në Prizren ku morën pjesë **Z. Zekë Çeku** – ekspert për turizëm, **Z. Urim Ukimeri** – koordinator për kulturë në Drejtorinë Komunale në Prizren dhe **Z. Veton Nurkollari** – drejtor artistik i DokuFest. Të gjithë të pranishmit ishin të pajtimit se Prizreni është ndoshta qyteti i vetëm në Kosovë që për momentin tërheq dhe ka potencial të mëtutjeshëm në tërheqjen e më shumë turistëve nga vendi dhe jashtë saj. Në anën tjetër u identifikuan edhe probleme të ndryshme që pengojnë konsumin kulturor, si për shembull mungesa e një orari të caktuar për vizitën e disa monumenteve historike, si Hamami. Po ashtu problem tjetër u cek edhe kufizimi i qasjes në disa objekte fetare ortodokse. Problem tjetër i identifikuar ishte mungesa e ciceronëve profesionist që eventualisht do të rriste vizitat në objektet e shumta

historike në Prizren. U vlerësua si pozitive zhvillimet si hartimi i kalendarit kulturor për qytetin e Prizrenit të hartuar nga Rrjeti i Organizatave Kulturore në Prizren, që sipas ekspertëve të turizmit paraqet një lehtësim për operatorët turistik që sjellin turistë në Prizren.

Debati i katërt me rend ishte mbi politikat e financimit të kulturës në nivelin lokal ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të partive politike nga LDK, AAK dhe VV. Debati me përjashtime të vogla respektivisht një partie politike, u karakterizua me klimën se partitë politike nuk kanë ndonjë plan konkret apo të veçantë për zhvillimin e kulturës në qytet, por kryesisht qëndrimet i kanë deklarative dhe shumë të përgjithësuara. Në anën tjetër u konstatua se edhe zhvillimet si aprovimi i një udhërrëfyesi për zhvillim të strategjisë kulturore nga komuna e Prizrenit janë të rëndësishme, por ato rrezikojnë të mbesin si dokumente të aprovuara pasi që nuk kanë ndonjë plan të veprimit. Në të njëjtën kohë u theksua se drejtorja për turizëm dhe zhvillim ekonomik në komunën e Prizrenit ka iniciuar hartimin e një strategjie tjetër e cila nga disa pjesëmarrës u interpretua si paralelizëm dhe u theksua nevoja për integrim të këtyre dy iniciativave me përfshirje të shoqërisë civile, mediet dhe komunitetin e biznesit. Problem tjetër u identifikua edhe mungesa e drejtorit të drejtorisë për kulturë në të gjitha debatet dhe ngjarje të rëndësishme për kulturë, gjë e cila lë të interpretohet edhe interesimin e drejtorit aktual për politikat kulturore dhe zhvillimin e kulturës në Prizren.

Konkluzionet dhe diskutimi

Të dhënat nga ky studim janë të dhëna të para të grumbulluara nga një mostër e randomizuar në qytetin e Prizrenit. Rezultatet në përgjithësi reflektojnë se kultura dhe aktivitetet kulturore janë të rëndësishme për qytetarët e Prizrenit. Diku rreth 12% e popullatës deklaroi se janë të përfshirë me ndonjë veprimtari si shkrim, ekzekutim të instrumentit apo janë pjesë e ndonjë organizimi kulturor që duket të jetë njëra nga resurset kryesore në qytet. Ky fakt është i rëndësishëm pasi që shumica dërmuese e organizimeve kulturore në qytetin e Prizrenit organizohen nga organizata të pavarura apo nga individë të caktuar. Diku rreth 10% të respondentëve kanë deklaruar se janë të përfshirë pasi janë pjesëmarrës në klube sportive dhe organizata vullnetare në baza javore që jep një indikacion për potencialin që mund të ketë shoqëria civile në këtë aspekt. Qytetarët e Prizrenit raportojnë nivel jo edhe aq të ultë të pjesëmarrjes në aktivitete kulturore, si për shembull vizita e teatrit me 28% është relativisht e lartë përpos nëse respondentët kanë perceptuar pyetjen nëse kanë shkuar në teatër kurdo. Një nga mundësitë për nivel relativisht të lartë të raportimit të pjesëmarrjes në aktivitete kulturore mund të jetë tendenca e natyrshme e respondentëve për tu shfaqur në dritë më pozitive se që janë, duke raportuar nivel më të lartë të vizitës të aktiviteteve kulturore. Dallimet gjinore kanë qenë të konsiderueshme pothuajse për të gjitha aktivitetet kulturore me nivel më të lartë të vizitës së aktiviteteve kulturore prej meshkujve. Diku rreth 41% të qytetarëve të Prizrenit kanë një perceptim se qyteti i Prizrenit ka më shumë aktivitete kulturore në krahasim me qytetet e tjera në Kosovë,

por respondentët më të rinj raportojnë nivele më të ulëta të pajtimit se Prizreni ka më shumë aktivitete kulturore në krahasim me qytetet e tjera në Kosovë. Në pyetjen nëse jeta kulturore dhe aktivitetet kulturore janë të rëndësishme në jetën e qytetarëve të Prizrenit, shumica dërmuese e respondentëve pa dallim në grup moshe deklaroi se ajo është e rëndësishme. Më saktësisht 67.6% kanë deklaruar se kultura dhe aktivitetet kulturore janë shumë të rëndësishme, 25.2% kanë deklaruar se janë mesatarisht të rëndësishme. Kjo e dhënë mund të konsiderohet si e rëndësishme pasi shpesh një nga arsyetimet e dhëna nga politik-bërësit (herë në formë të qarta e herë në formë të mjegullta) mbi mungesën e financimit të aktiviteteve kulturore është se qytetarët kanë prioritetë të tjera dhe se kultura është më pak e rëndësishme për ta. Ky qëndrim është konfirmuar me atë se më se 82% pajtohen ose fuqimisht pajtohen me atë se komuna duhet të ndajë më shumë mjete për aktivitete kulturore. Pyetësori për matjen e qëndrimeve ka rezultuar se në përgjithësi qytetarët e Prizrenit pa dallime demografike kanë raportuar të kenë qëndrime pozitive ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore në qytet.

Tri arsye që duket të kenë ndikim në vendim marrjen për pjesëmarrje në aktivitete kulturore kanë qenë të kënaqen me familjen apo shoqërinë, të ketë argëtim dhe të jetë interesante. Ndërsa arsyeja kryesore për mos-pjesëmarrje në aktivitetet kulturore është cekur të jetë mungesa e kohës. Sa i përket preferencave të aktiviteteve kulturore në qytetin e Prizrenit ka rezultuar me këtë renditje: kinema që punon çdo ditë, shfaqje më të shpeshta për fëmijë, shfaqje të përditshme të teatrit dhe më shumë festivale të ndryshme.

Organizatave kulturore në Prizren janë të organizuar për herë të parë në rrjetin e organizatave kulturore të Prizrenit. Kjo duket të jetë një proces i natyrshëm kur edhe këto organizata janë prodhues kryesor të jetës kulturore në qytet. Duke se bashkëpunimi i organizatave në nivelin lokal është më i lartë në krahasim me atë në nivelin e vendit dhe atë regional. Të gjeturat e hulumtimit me organizatat kulturore rezultojnë nivel relativisht të ultë të të punësuarve të rregullt gjegjësisht me 1.32 person për organizatë. Një nga potencialet e organizatave të intervistuar duket të jetë numri i vullnetarëve që ndoshta është në përputhje me shifrën prej 10% nga hulumtimi i popullatës që deklaruan se marrin pjesë në aktivitete vullnetare në organizata të ndryshme. Tjetër fakt i rëndësishëm i dalë nga ky hulumtim është se ende fondacionet ndërkombëtare mbasin si financues kryesor të aktiviteteve të organizuara nga organizatat e pavarura në Prizren, ku organet komunale dhe ato qendrore me mesatare të përqindjes janë mbrapa donatorëve individual dhe bizneset vendore. Një përqindje e madhe e organizatave të intervistuar kanë zyre të veta për të cilat shumica janë duke paguar qera. Më se gjysma e organizatave të intervistuar kanë deklaruar se nuk kanë marrë pjesë në proceset të ndërlidhura me politikën lokale kulturore.

Të dhënat nga katër debate të ndryshme nxjerrin në pah pajtimin e gjerë në mes të akterëve të ndryshëm të shoqërisë civile, partive politike, pushtetit lokal, ekspertëve të turizmit, grupe të ndryshme të interesit për kapacitetin e qytetit të Prizrenit për ofertë më serioze kulturore dhe mos-përgjigjen e organeve komunale dhe atyre qendrore ndaj këtij kapaciteti potencial. Një

pajtim tjetër i gjerë është nevoja e një bashkëpunimi më të gjerë në mes të shoqërisë civile, të biznesit dhe medieve dhe qeverisë lokale për zhvillimin e politikave kulturore, por pa e përcaktuar në mënyrë konkrete se si të bëhet kjo. Prizreni karakterizohet me buxhet të ultë të kulturës në krahasim me numrin e aktiviteteve që ofrohen në qytet pothuajse kryekëput nga sektori pavarur kulturor. Po ashtu nuk ka ndonjë mekanizëm të qartë të financimit të aktiviteteve kulturore, pasi që nuk ka konkurs vjetor dhe nuk ka mekanizma të vlerësimit cilësor të aktiviteteve të financuar nga paraja publike.

Të dhënat nga ky hulumtim reflektojnë qëndrimet dhe perceptimet e qytetarëve të Prizrenit mbi kulturën, aktivitetet kulturore dhe një analizë të organizatave kulturore që veprojnë në Prizren dhe qëndrimet e akterëve të tjerë relevantë me fushën e kulturës në qytetin e Prizrenit. Mund të nxirret përfundimi se qytetarët e Prizrenit kanë perceptime pozitive mbi numrin e aktiviteteve kulturore në Prizren dhe konsiderojnë se kultura është e rëndësishme në jetën e tyre dhe se komuna duhet të investojë më shumë në aktivitetet kulturore. Në anën tjetër kemi një grup të organizatave kulturore të cilët janë pothuajse bartës kryesor të organizimit të ngjarjeve kulturore në qytet dhe mjaft aktive. Këto dy konkluzione sjellin në pah një hallkë të dobët që ka të bëjë me organet komunale që nuk e kanë parasysh ende rëndësinë e kulturës dhe artit si mjet i demokratizimit të mëtutjeshëm të shoqërisë Kosovare dhe të zhvillimit ekonomik që është konstatuar edhe në katër debate publike të organizuara si pjesë e këtij hulumtimi.

Në mënyrë që të "prodhohet" dhe të stimulohet kultura në qytet rekomandohen

që të zhvillohen politikat kulturore, që do të përcaktojnë se çka, kur dhe si do të përkrahen aktivitetet kulturore në një qytet, madje duke siguruar që kultura definohet gjerë duke përfshirë forma të ndryshme të artit, kuzhinën, trashëgiminë kulturore, ruajtjen e vlerave tradicionale etj.

Diskutim

Përvojat nga vende të tjera në Europë tregojnë se prezantimi i kulturave politike urbane ka qenë një proces i ngadalshëm (Garcia, 2004)³. Debatimi mbi të në Europë ka filluar në vitet 1990 dhe është përqendruar në atë se politikat kulturore ndihmojnë regjenerimin dhe zhvillimin urban. Kritikët ndaj kësaj qasjeje kanë theksuar se politikat e tilla stimulojnë më shumë konsumimin se sa prodhimin (Bianchini, 1999)⁴, por konteksti në Prizren nuk e ka këtë dilemë pasi që qyteti ballafaqohet me një situatë ku konsumi është kryekëput i varur nga oferta kulturore që ofrohet nga skena e pavarur në qytet dhe ajo është shumë më e varfër në krahasim me vende të tjera europiane. Prandaj rezultatet e hulumtimit tregojnë se zhvillimi i politikave kulturore në nivel të qytetit do të rriste konsumin dhe prodhimin. Politikat kulturore do të strukturin këtë nevojë për konsum që është vërtetuar me hulumtim të kapacitetit të prodhimit që ekziston në qytetin e Prizrenit.

Siç u tha në fillim nëse nuk ka politikë zyrtare për kulturë, nuk do të thotë se një

vend nuk ka asnjë politikë kulturore dhe kjo më shumë tregon se ka politika të mjegullta, të cilat shërbejnë për të mbajtur një status quo apo për të vazhduar inercionin ekzistues.

Por pengesa kryesore që shkakton mungesa e politikave të qarta kulturore apo e diskutimit për to është se pengon diskursin se cila është vlera e artit dhe kulturës në shoqëri, dhe për këtë politikat e padukshme janë jodemokratike dhe të papërgjegjshme (Atlas)⁵. Prandaj hapja e një diskursi dhe procesi konstruktiv në mes të akterëve kulturor dhe organeve komunale në këtë situatë lexo politik-bërës do të iniciojë një proces të natyrshëm për procesin dhe nxjerrjen e një politike kulturore për qytetin e Prizrenit si një produkt. Në këtë proces do të kishte një debat për atë se cilat janë vlerat e artit dhe kulturës në qytetin e Prizrenit duke përfshirë dimensionin prodhues, ekonomik dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të dialogut në mes të institucioneve dhe qytetarëve të organizuar në skenën e pavarur kulturore apo edhe qytetarëve të tjerë të Prizrenit. Konsiderohet që ky të jetë një proces i natyrshëm gjersa Kosova provon të konsolidojë organet publike dhe në të njëjtën kohë kemi rënie të përkrahjes së donatorëve ndërkombëtar (edhe pse 1/4 e aktiviteteve kulturore ende përkrahet nga fonde të huaja). Zhvillimi i politikave kulturore nuk duhet të shihet si një barrë apo shpenzim shtesë nga organet komunale, por të konsiderohet si një mundësi që mund të sjell një regjenerim urban dhe mundësi të reja për zhvillime kulturore por edhe me të edhe ato ekonomike.

³ Garcia, B. (2004). Cultural policy and urban regeneration in Western European Cities: Lessons from Experience, Prospects for the Future. Local Economy, 19, 312-326.

⁴ Bianchini, F. (1999). Cultural planning for urban sustainability, in L. Nystrom & C. Fudge (Eds) Culture and cities, Cultural Processes and Urban Sustainability, pp. 34-51 (Stockholm: The Swedish Urban Development Council).

⁵ Atlas, C. Cultural policy: What Is It, Who Makes It, Why Does it Matter?, marrë nga: www.nyfa.org/files_uploaded/pages_65-68.pdf

Shtetet europiane me qëllim në 30 vite të fundit kanë investuar në zhvillimin e kulturës jashtë kryeqyteteve⁶, dhe edhe niveli qendror në Kosovë duhet më shumë të investojë në kulturë e posaçërisht në trashëgiminë kulturore në qytetin e Prizrenit, pasi që fatkeqësisht shumica e qyteteve të tjera në Kosovë nuk kanë objekte me vlerë për trashëgiminë kulturore aq sa janë ndoshta në Prizren. Për këtë edhe ndoshta qyteti i Prizrenit duhet të prioritetizohet edhe më shumë në kuadër të politikave dhe vendimeve eventuale që merren në nivelin qendror.

Nga të dhënat e hulumtimit dhe momentit të caktuar kur del ky raport është organizimi i të gjithë akterëve kryesor në qytetin e Prizrenit të shoqërisë civile, drejtorive të kulturës, rinisë, sportit, të zhvillimit ekonomik, urbanizmit që të punojnë se bashku në hartimin e politikave kulturore, të cilat bazohen në të dhëna, në potencialet ekzistuese dhe nevojat e qytetarëve të Prizrenit dhe synimit të qenit kryeqytet kulturor me veprime në vend të fjalive deklarative.

Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij dokumenti bazohen në të dhëna të grumbulluara nga qytetarët e Prizrenit, nga organizatat kulturore që veprojnë në Prizren dhe nga debate të ndryshme me akterë relevant nga niveli lokal dhe qendror. Dokumenti synon të hap një diskurs të shëndoshë mbi hapat konkrete që duhet të

bëhen në zhvillimin e kulturave politike të qytetit të Prizrenit.

Limitimet e studimit

Shpërpjesëtimi në mes gjinive në hulumtim mund të jetë edhe si rezultat i mos përcjelljes së randomitetit (rastit) nga ana e intervistuesve. Një kufizim tjetër i studimit mund të jetë edhe tendenca e mbi raportimit të pjesëmarrjes në aktivitete kulturore gjë që mund të rezultojë me nivele jo reale pjesëmarrjes në aktivitete kulturore. Nivele relativisht të njëjta të larta janë gjetur edhe në hulumtime të kaluara me qytetarë të Prizrenit⁷.

⁶ Bianchini, F. (1993). Remaking European cities: the role of cultural policies. *Cultural policy and urban regeneration: The West European experience*, 1-20

Bianchini, F. (1993). Remaking European cities: the role of cultural policies. *Cultural policy and urban regeneration: The West European experience*, 1-20

⁷http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Jeta_kulturore_ne_Pz.pdf

- Analizë e shkurtë
- Transkriptet e debateve I, II, III, IV
- Pyetësoni

Analizë e shkurtë

Politikat kulturore dhe Qyteti

Kosova ende nuk e ka një strategji të zhvillimit kulturor, dhe kjo tregon që Qeveria e Kosovës nuk e ka listuar kulturën si prioritet në rrugën e saj drejt zhvillimit. Edhe kultura, si çdo sferë tjetër e jetës duhet të rregullohet me ligje, të zhvillohet sipas standardeve specifike dhe të përdoret për zhvillim shoqëror. Ani pse deri vonë kultura është konsideruar më shumë si luks sesa si nevojë elementare e njerëzve, ajo tani ka filluar të konsiderohet si shtylla e katërt e zhvillimit të shoqërisë, së bashku me shtyllën ekonomike, sociale dhe ekologjike

Duke ditur se politikat kulturore krijojnë mundësi që asnjë sferë tjetër publike nuk i ofron, dhe duke ditur që këto politika janë të ndërtuara mbi vlerat thelbësore të kulturës të cilat përfshijnë konceptet si kujtesa, kreativiteti, dija kritike, ritualet, përsosmëria, bukuria e diversiteti, atëherë institucionet publike duhet të gjejnë ligjet dhe politikat, e më pastaj edhe programin dhe projektet për të garantuar të gjithë qytetarët që përmes kulturës të arrijnë zhvillimin e tyre njerëzor.¹

Kultura dhe zhvillimi i saj janë të drejta themelore të njeriut bazuar në Deklaratën Univerzale të Drejtave të Njeriut të vitit 1948.² Neni 27 i kësaj deklarate thotë:

“Të gjithë kanë të drejtë që lirshëm të marrin pjesë në jetën kulturore të komunitetit, të shijojnë artet dhe të përfitojnë nga përparimi shkencor dhe dobietë e tij”.

Sipas znj. Simjanovska, e cila është eksperte e politikave kulturore në Maqedoni, “kultura ka të bëjë me ndjenjën e mirë e të jetuarit në qytet, në ambientin e përditshërisë tonë, kualitetin e jetës kulturore i cili është motiv i rëndësishëm për sipërmarrësit që të zgjedhin qytetin për investim dhe jetesë, për punësim, diversifikimin dhe ngritjen e kualitetit të jetës, pra ajo është pjesë e pandashme e jetës së përditshme.”³

Në dokumentin e hartuar nga Forumi Kulturor (Rrjet i organizatave të pavarura të kulturës), i cili i është drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të argumentuar nevojën që Kosova të ketë një strategji kulturore thuhet se, “Niveli lokal (komunal) është njëri nga dimensionet më të ndjeshme të planifikimit të kulturës. Strategjia mund të ofrojë një strukturë dhe udhëzime shumë të qarta për zhvillimin kulturor lokal dhe mundësitë e bashkëpunimit mes dy niveleve të qeverisjes. Vendosija e parimeve të përgjithshme të zhvillimit kulturor në nivel qendror dhe lokal, do të hapte rrugën për hartimin e strategjive lokale të kulturës, të cilat do të jenë më të fokusuara dhe të bazuara në kontekstet specifike kulturore.”⁴

¹ European Cultural Foundation, Local Cultural Policies Handbook, fq. 26, në http://www.culturalfoundation.eu/sites/www.culturalfoundation.eu/files/local_cultural_policies_handbook_eng_2011.pdf

² European Cultural Foundation, Local Cultural Policies Handbook, fq. 23 në http://www.culturalfoundation.eu/sites/www.culturalfoundation.eu/files/local_cultural_policies_handbook_eng_2011.pdf

³ Konferenca Rajonale “Politikat Kulturore dhe Qytetet” Violeta Simjanovska – Eksperte e Politikave Kulturore në Maqedoni në <http://www.culturist-ks.org/sq/Aktivitete-kulturore/KONFERENCA-RAJONALE-POLITIKAT-KULTURORE-DHE-QYTETI-47>

⁴ Forumi Kulturor – “Pse na duhet një strategji kulturore” fq. 6, në <http://forumikulturor.net/cms/wp-content/uploads/2012/11/Pse-na-duhet-nj%C3%AB-Strategji-e-Kultur%C3%ABs.pdf>

Në anën tjetër, sipas hulumtimit të bërë për hartimin e politikave kulturore në nivel lokal në Turqi, “në shekullin 21, qytetarët nuk e definojnë veten në bazë të punës që bëjnë ngase shumë nga ata bëjnë punë të ndryshme, ri-edukohen e shumë gjëra tjera, prandaj qytetarëve ju duhet kultura çdo ditë e më shumë për ti dhënë kuptim jetës së tyre, të konstruktojnë identitetet individuale dhe kolektive.”⁵

Potenciali i neglizhuar

Qyteti i kulturës Prizreni, është qyteti me më së shumti aktivitete gjatë vitit pas kryeqytetit, dhe 90 % të këtyre aktiviteteve organizohen nga organizatat e pavarura kulturore. Sipas hulumtimit që është bërë, këto aktivitete janë rritur konsiderueshëm gjatë 3 viteve të fundit. Prizreni karakterizohet në të njëjtën kohë për trashëgiminë kulturore dhe potencialin e tij turistik.

Qytetarët e Prizrenit dhe organizatat e pavarura kulturore janë të vetëdijshëm për këtë potencial dhe mundohen me çdo kusht ta mbrojnë, ta promovojnë dhe ta shfrytëzojnë për zhvillim të përgjithshëm të qytetit. Në anën tjetër, institucionet qendrore por edhe ato lokale nuk e vlerësojnë ose nuk duan ta vlerësojnë sa duhet këtë potencial ekzistues. Për këtë më së miri tregon buxheti i përgjithshëm i shtetit për kulturën, dhe në të njëjtën kohë buxheti komunal i Prizrenit për përkrahjen e kulturës dhe të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me të.

Gjatë një viti në Prizren organizohen pothuajse 40 evente kulturore, pjesa më e madhe e tyre mbledhin shumë njerëz nga vende të ndryshme të Kosovës dhe rajonit. Festivali i filmit dokumentar Dokufest është një prej ngjarjeve kulturore më të mëdha në rajon si dhe njëri prej 25 festivaleve më të mirë në botë. Ky festival që organizohet në Prizren për 10 vite me rradhë mbledh me mijëra njerëz në këtë qytet përgjatë 10 ditëve sa zgjat festivali. Gjatë këtyre ditëve përfitimi rritet në masë të madhe duke përfshirë bizneset lokale, por edhe ato shtetërore. Analiza e punuar nga Instituti GAP për ndikimin e DokuFest-it në ekonominë në nivel lokal dhe në nivel qendror, tregon që “kjo ngjarje kulturore ka impakt më të madh në ekonominë e vendit sa sa buxheti me të cilin operon, prandaj komunat dhe Qeveria e Kosovës duhet të krijojnë kushte për funksionimin e organizatave të cilat kanë potencial që një investim të vogël ta kthejnë në përfitime të mëdha për ekonominë lokale.”⁶

Sipas kësaj analize politikash, ndikimi i DokuFest-it në vitin 2011 në Bruto Produktin e Brendshëm arrin një sasi vjetore prej 3.100.000 €, dhe nëse vlerësohen shpenzimet e konsumatorëve, ndikimi arrin 3.800.000 €. Ajo rezulton se në e katër vitet e ardhshme ndikimi i DokuFest-it në GDP-në e vendit do të jetë të paktën 17.500.000.⁷

Duke e parë nevojën për një mekanizëm i cili to të kordinonte punët, ngjarjet dhe aktivitetet kulturore organizatat e pavarura të kulturës morën iniciativën e krijimit të një rrjeti të këtyre organizatave. Kjo iniciativë u përkrah fillimisht nga 15 organizata të cilat janë themeluese të këtij rrjeti, ndërsa shumë shpejtë u bashkangjiten edhe 7 organizata tjera. Misioni i Rrjetit është të arrijë një ekonomi lokale të zhvilluar në Prizren përmes aktiviteteve kulturore, ndërsa në anën tjetër objektivat kryesore janë: pasurimi i jetës kulturore, ngritja e kualitetit të aktiviteteve ekzistuese,

⁵ European Cultural Foundation, “Local Cultural Policies Handbook” fq. 26 në http://www.culturalfoundation.eu/sites/www.culturalfoundation.eu/files/local_cultural_policies_handbook_eng_2011.pdf

⁶ Instituti GAP, “Ndikimi Ekonomik i DokuFest-it”, fq. 1 në http://www.institutigap.org/documents/66380_ImpaktiEkonomikDokufest.pdf

⁷ Instituti GAP, “Ndikimi Ekonomik i DokuFest-it”, fq. 1 në http://www.institutigap.org/documents/66380_ImpaktiEkonomikDokufest.pdf

përmirsimi i politikave kulturore në nivel komunal, menaxhim i decentralizuar i kulturës dhe iniciimi i qytetarisë përgjegjëse dhe aktive.⁸

Neglizhienca e treguar nga autoritetet lokale të komunës së Prizrenit për të gjithë potencialin që ka kjo komunë, ka bërë që sektori i kulturës së pavarur të organizohet me forca të veta për të ndryshuar gjendjen ekzistuese në këtë komunë. Nga hulumtimi i bërë me qytetarët për rëndësinë e organizatave kulturore, shohim se çdo i 3-ti qytetar mendon se gjatë 5 viteve të fundit këto organizata kanë pasur rol pozitiv tek qytetarët, 9 nga 10 qytetarë mendojnë se kultura është e rëndësishme për jetën e qytetarit dhe vetëm 1 nga 10 qytetarët mendon se komuna investon mjaftueshëm në sektorin e kulturës.

Financimi i Kulturës

Autoritetet publike vazhdojnë ta shohin kulturën si një luks shoqëror, gjithmonë duke u fshehur pas arsytimit se institucionet kanë prioritete më të rëndësishme zhvillimore, duke filluar sipas tyre me përmirësimin e mirëqenies sociale në vend.

Ky qëndrim është mjaft kundërthënës në vete ngase mirëqenia sociale, zhvillimi ekonomik dhe shumë fusha tjera të jetesës mund të përmirsohen përmes shfrytëzimit të kulturës si burim i zhvillimit e jo duke e ndarë kulturën totalisht nga zhvillimi i shoqërisë. Autoritetet publike qendrore e as ato lokale ende nuk kanë arritur të kuptojnë se kultura nuk është luks por është nevojë për qytetarin, kultura sjell vende të reja të punës dhe në këtë mënyrë kontribuon në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike.

Qeveria e Kosovës investon në kulturë rreth 5 euro për kokë banori në vit, e në nivelin komunal gjendja është edhe më e vështirë duke u nisur nga komuna e Prizrenit si komuna me më së shumti aktivitete kulturore e poashtu e pasur në aspektin e trashëgimisë kulturore. Qeveria lokale investon në kulturë rreth 2 euro për kokë banori.⁹ Me fjalë të tjera, Komuna e Prizrenit qaras qytetarët e saj me 1 burek dhe 1 jogurt gjatë 1 viti.

Komuna e Prizrenit kontribuon me vetëm 7.3 % për të gjitha aktivitetet e kulturës së pavarur gjatë tërë vitit. Në të njejtën kohë, vetëm 1 nga 10 qytetarët e pyetur për kontributin e komunës për aktivitetet kulturore mendojnë që komuna investon dhe përkrah mjaftueshëm kulturën në Prizren.

Sistemi i financimit të kulturës në Kosovë nuk është i rregulluar në baza meritore dhe kriteret të cilësisë. Në këtë sistem ka pabarazi të shpërndarjes së këtyre fondeve nëse e krahasojmë prodhimtarinë e sektorit të pavarur të kulturës me sektorin publik. Institucionet publike të kulturës vazhdojnë të përfitojnë pjesën më të madhe të fondeve shtetërore edhe pse sektori i kulturës së pavarur është prodhuesi më i madh artistik dhe kulturor në vend, si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor.

Kjo situatë që mbretëron në institucionet e Kosovës duhet të ndryshojë në mënyrë që edhe Kosova të shfrytëzojë potencialin e saj kulturor për zhvillim të qëndrueshëm. Kjo pasi që shumë studime të realizuara viteve të fundit kanë zbuluar se paraja publike e dedikuar për arte paraqet një investim të

⁸ Rjeti i organizatave kulturore në Prizren –RrOK në <http://www.rrok-pz.net/?page=1,2>

⁹ Forumi Kulturor “Pse na duhet një strategji e kulturës”, fq. 1 në <http://forumikulturor.net/cms/wp-content/uploads/2012/11/Pse-na-duhet-nj%C3%AB-Strategji-e-Kultur%C3%ABs.pdf>

mençur për institucionet e shtetit. Në anën tjetër kultura, industritë kreative dhe kreativiteti kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në tejkalimin e efekteve të krizës globale.¹⁰

Politika që nuk bën Politika

Sipas z. Aliriza Arënliu nga DokuFest, duke u bazuar në përvojën e tij gjatë viteve të organizimit të festivalit “tek ne politikë kulturore është të mos ketë politikë kulturore, dhe se kjo u shërben institucioneve për të shpërblyer ose ndëshkuar dikë në kohëra të caktuara.”¹¹ Në të njejtën kohë, ai shpreh skepticizmin e tij sa i përket motivimit të sinqertë nga ndonjë strukturë politike për të përkrahur dhe zhvilluar kulturën.

Sektori i politikave kulturore publike është njëri ndër sektorët më të pazhvilluar dhe problematik. Korniza ligjore e trashëguar qysh nga administrimi i UNMIK-ut ka në vete shumë probleme, duke pasuar me pasivitet total nga ana e institucioneve për të debatuar për një model të duhur ligjor që do ta rregullonte sektorin e kulturës.

Veprimtaria artistike dhe ngjarjet kulturore kryesisht ndodhin në realitete lokale dhe janë të mishëruara me kulturat e komuniteteve që jetojnë në ato lagje, qytete e fshata. Ndërsa komunat vazhdojnë të shohin menaxhimin apo qeverisjen e kulturës si financim i festivaleve apo aktiviteteve kulturore, apo ndërtimin e objekteve kulturore-sportive, dimensionin administrativ i menaxhimit të kulturës është pjesa më e neglizhuar e problemit.

Bazuar në dokumentin e Forumit Kulturor “Pse na duhet një strategji e Kulturës”, komunat kanë buxhete të mjerueshme për kulturën, ndërsa artistët trajtohen si kategori të cilës i jepet lëmoshë. Kjo është si rezultat i mungesës pothuajse totale të politikave kulturore në nivel lokal, fakt ky i cili shkëput kulturën nga planifikimi i zhvillimit lokal duke e shndërruar në një koncept elitist që e kufizon aktivitetin kulturor tek një grup i vogël njerëzish.¹²

Për të rregulluar sektorin e kulturës zhvillimi i kulturave politike duhet të ndodh nga “poshtë – lart” duke përfshirë shoqërinë civile, organizatat kulturore, artistët dhe qytetarët në përgjithësi. Përfshirja e qytetarëve në hartimin e politikave është praktikë që ka filluar para disa dekadave dhe konsiderohet si karakteristikë e demokracisë së avancuar. Edhe pse pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e hartimit të politikave dhe proceset vendimmarrëse është duke u bërë praktikë në vendet demokratike, për të siguruar këtë pjesëmarrje jo vetëm në fazën e planifikimit por gjatë gjithë procesit duhet të përshtaten dhe zbatohen metoda të ndryshme dhe kreative.¹³

Pjesëmarrja e qytetarëve të komunës së Prizrenit në hartimin e politikave publike është mjaft e ulët. Sipas hulumtimit të bërë për veprimtarinë e organizatave kulturore në Prizren, shohim se vetëm 8.6 % e këtyre organizatave marrin pjesë në hartimin e politikave kulturore, e megjithatë Prizreni nuk ka politika të mirëfillta kulturore sepse komuna vazhdon të neglizhojë rolin e rëndësishëm të kulturës dhe ta shohë atë si potencial të zhvillimit lokal.

¹⁰ Forumi Kulturor “Pse na duhet një strategji e Kulturës”, fq. 4 në <http://forumikulturor.net/cms/wp-content/uploads/2012/11/Pse-na-duhet-nj%C3%AB-Strategji-e-Kultur%C3%ABs.pdf>

¹¹ Forumi Kulturor “Konferenca Vjetore e Forumit Kulturor”, në <http://forumikulturor.net/cms/?p=456>

¹² Forumi Kulturor “Pse na duhet një strategji e Kulturës”, fq. 3 në <http://forumikulturor.net/cms/wp-content/uploads/2012/11/Pse-na-duhet-nj%C3%AB-Strategji-e-Kultur%C3%ABs.pdf>

¹³ European Cultural Foundation, “Local Cultural Policies Handbook,” fq. 18 në http://www.culturalfoundation.eu/sites/www.culturalfoundation.eu/files/local_cultural_policies_handbook_eng_2011.pdf

Rekomandime

Bazuar në hulumtimin e bërë nga EC Ma Ndryshe për rolin e organizatave kulturore në komunën e Prizrenit, hulumtimin për perceptimet, qëndrimet dhe sjelljet e qytetarëve të Prizrenit ndaj kulturës, e poashtu duke u bazuar në literaturën ekzistuese sa i përket rëndësisë së kulturës për jetën e qytetarit ne kemi disa rekomandime për përmirsimin e mundshëm të situatës ekzistuese

- Institucionet e qeverisjes lokale si dhe ato qëndrore duhet të vendosin kulturën në listën e prioriteteve të zhvillimit të vendit, si dhe të inicojnë rregullimin ligjor të sferës së kulturës.
- Institucionet lokale në Prizren duhet të trajtojnë kulturën si njërin prej shtyllave kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës .
- Duke u bazuar në potencialin kulturor që ka komuna e Prizrenit dhe duke ditur që kësaj sfere i ndahet buxhet jashtëzakonisht i vogël, ne rekomandojmë që institucionet lokale të kenë parasysh nevojat e qytetarëve dhe të akterëve kulturor para së të hartojnë buxhetet vjetore.
- Mungesa e politikave të mirëfillta kulturore i ka sjellë pasoja të vazhdueshme gjatë viteve sektorit të kulturës. Politikat ad-hoc të zbatuara tash e sa vite vetëm e kanë dëmtuar procesin e zhvillimit të kësaj sfere aq të rëndësishme për qytetarët. Prandaj, hartimi i politikave të mirëfillta publike për sektorin e kulturës është hapi i parë dhe esencial për përmirsimin e gjendjes ekzistuese në këtë sektor.

Pjesëmarrja Qytetare në Politikat Kulturore Lokale

Z. Hajrulla Çeku – Drejtor Ekzekutiv i OJQ EC Ma Ndryshe, hapi zyrtarisht debatin dhe në të njejtën kohë shpjegoi në pika të shkurtëra qëllimin e projektit në kuadër të të cilit ishte organizaur debati. Qëllimi kryesor i këtij projekti sipas Z. Çeku është që sektori i kulturës në aspektin e gjerë duke filluar nga artistët individual, organizatat e kulturës, institucionet publike të kulturës, aktivistët e kulturës të jenë pjesë e vendimarrjes, konkretisht të jenë pjesë e hartimit të politikave kulturore dhe zbatimit të tyre. Ai poashtu prezantoi edhe dy panelistët tjerë që ishin Alirizë Arënliu dhe Besar Haxhibeqiri. Z. Arënliu, ishte aty në cilësinë e bartësit të hulumtimit dhe pjesë e stafit të projektit, ndërsa Z. Haxhibeqiri në cilësinë e kordinatorit të Rrjetit të Organizatave Kulturore në Prizren – Rrok.

Në vazhdim **Z. Arënliu** mori fjalën dhe para se të fillonte të prezentonte hulumtimin qartësoi disa gjëra për pjesëmarrësit. Z. Arënliu bëri të ditur se të dhënat e hulumtimit ishin preliminare, pastaj, sipas tij, duke u bazuar në artikuj të ndryshëm sa u përket hulumtimeve që bëhen për pjesëmarrjen në aktivitetet kulturore, gjithmonë është mundësia e mbi-raportimit për pjesëmarrje, dhe e fundit, ishte që ai kishte përgaditur dy prezente me temat të cilat ai kishte konsideruar se janë të rëndësishme të diskutohen.

Z. Arënliu, në fillim të prezentimit ceki se do të prezentonte rezultatet e dy hulumtimeve që ishin bërë deri tani, njëri hulumtim ishte bërë me qytetarët e Prizrenit dhe tjetri me organizatat e pavarura kulturore të Prizrenit. Sipas tij, hulumtimi me qytetarët e Prizrenit tregon më shumë për pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitetet e ndryshme kulturore në qytet si dhe perceptimet dhe qëndrimet e tyre në përgjithësi ndaj kulturës dhe aktiviteteve kulturore. Ky hulumtim ishte bërë me 500 respondente në 20 vendbanime në qytetin e Prizrenit. Ndërsa, hulumtimi me organizatat kulturore është bërë me 23 organizata të pavarura kulturore i cili ka pas për qëllim një lloj profilizimi të këtyre organizatave, ky hulumtim është kryer nga OJQ EC Ma Ndryse.

Prezentimet e hulumtimeve i bashkangjiten këtij raport.

Pas prezenteve të Z. Arënliu, **Z. Çeku** bëri një përmbledhje të shkurtër për esencën dhe nevojën e realizimit të këtij hulumtimi pasi që sipas tij, komuna asnjëherë nuk ka bërë ndonjë hulumtim të tillë për të kuptuar qëndrimet, perceptimet, besimet ose edhe preferencat e qytetarëve ndaj kulturës. Ai poashtu shtoi se, për hartimin e politikave kulturore në qytetin e Prizrenit pjesëmarrja e qytetarëve është e nevojshme. Për të vazhduar debatin ai i dha fjalën kordinatorit të Rrok-ut, Z. Haxhibeqiri, i cili do të tregonte arsyet e themelimit të këtij rrjeti, objektivat kryesore të tij dhe aktivitetet e rrjetit.

Z. Haxhibeqiri, bëri një përmbledhje të formimit të Rrok-ut duke cekur se ky rrjet është rrjet jo formal i organizatave kulturore të Prizrenit dhe misionin e këtij rrjeti që është: rritja e ekonomisë së zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës kulturore bazuar në rritjen e cilësisë dhe vëllimit të aktiviteteve kulturore. Objektivat kryesore të këtij rrjeti sipas Z. Haxhibeqiri janë; hartimi i politikave kulturore në Prizren, koordinimi i këtyre organizatave sepse vetëm atëherë mund të jenë më të fuqishëm dhe më të zëshëm dhe formimi i ofertës kulturore turistike i Prizrenit. Aktiviteti i Rrok-ut është formimi i kalendarit kulturor i cili do të përfshijë të gjitha të dhënat për të gjitha aktivitetet kulturore që ndodhin brenda vitit në qytetin e Prizrenit. Ndër aktivitetet e

Rrok-ut, Z. Haxhibeqiri potencoi Memorandumin e Mirëkuptimit për bashkëpunim mes Rrok-ut dhe Drejtorise për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm.

Pas prezentimit nga Z. Haxhibeqiri për Rrok-un dhe rolin e tij, dhe para filimit të diskutimit të hapur Z. Çeku lexoi letrën e dërguar nga Ruzhdi Rexha – nënkryetar i Komunës së Prizrenit i cili nuk qe pjesëmarrës në debat. Pas leximit të letrës Z. Çeku hapi diskutimin ku pyetjet për pjesmarrësit ishin: cka treguan të dhënat e hulumtimeve për ta, sa ka potencial sektori i kulturës të ndikoj në politikat kulturore në Prizren dhe vlerësimi i tyre i përgjithshëm.

Z. Ardian Firzi - “Industria e Muzikës”, sugjeroi që në organizimin e kulturës duhet të merren si shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të bëhet profilizimi i organizatave ose i organizatoreve dhe të ndahen fushat se kush merret me organizim të festivaleve të filmit e kush me të muzikës dhe sipas tij vetëm më këtë profilizim mund të ndërtohen politika të mirëfillta kulturore. Ndërsa s Z. Arënlju replikoi duke thënë që profilizimi i organizatave duhet të bëhet patjetër por është pak problem me ju percaktu njerzve së çka duhet të bëjnë, ngase njëra ndër bazat e asocimit të lirë dhe baza e organizimit të aktiviteteve kulturore është liria e organizimit të njerëzve.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prizrenit **Z. Sadik Paçarizi**, foli për qendrën “Europa” e cila është ndërtuar me ndihmën e Bashkësisë Europiane. Sipas tij, kjo qendër mund të jetë një mundësi e mirë bashkëpunimi në mes të sektorit të kulturës dhe urbanizmit dhe ftoi për përkrahje të gjithë aktërët e shoqërisë e sidomos ata të sektorit kulturës që ajo qendër të funksionalizohet dhe të shfrytëzohet për promovim të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe për nevojat e qytetarëve të Prizrenit.

Përfaqësuesi i Shoqatës së Zejtarëve të Prizrenit sqaroi strukturën e bordit të Kompleksit Europa, që sipas tij ai bord është i përbër edhe prej OJQ-ve, Dokufest-it dhe Shoqatës së Zejtarëve dhe që ky projekt nuk është i sponzorizuar nga kuvendi por i përfituar dhe varet nga bordi se si do të menaxhohet.

Sipas **Z. Hasan Hoti** - Drejtor i Institutit për Mbrojtje e Monumenteve, fati i keq është që në këtë takim ku flitet për politikat kulturore nuk është prezente Drejtoria e Kulturës por Drejtoria e Urbanizmit dhe se hulumtimi i prezentuar është një punë e mirë në aspektin teorik, statistik dhe të përpunimit, duke shprehur që nuk mbetet vetëm si një hulumtim por do të shërbejë për një organizim më të mirë të jetës shoqërore dhe kulturore në qytet. Ai vazhdoi duke pyetur se cka do të ndodh pas publikimit të këtij hulumtimi, kush do të merret me procesin e hartimit të politikave, pasi që interesimi i zyrtarëve që janë përgjegjës për këtë proces tashmë është i qartë. Në fund ai tregoi gadishmërinë për përkrahje të kësaj iniciative nga Instituti të cilin ai përfaqëson.

Folësi i rradhës ishte Z. **Arben Shala** nga Fondacioni për Trashëgimi Kulturore “Legatum”, i cili fillo duke thënë se pjesa e hulumtimit e vecanërisht pjesa e perceptimeve të qytetarëve ndaj kulturës duhet të shërbejë si udhërrëfyes për punën e Rrok-ut. Kjo ngase sipas hulumtimit shumica e respondentëve konsumojnë kulturën vetëm për shkaqe kënaqësie dhe argëtimi përderisa konsumimi i kulturës nuk kufizohet me aq, ai në pjesën më të madhe ka të bëjë me vlerat, ruajtjen e vlerave dhe promovimin e tyre dhe me identitetin kulturor e kombëtarë të një populli. Ai sugjeroi që organizatat e kulturës mos të fokusohen vetëm në anën komerciale të aktiviteteve por të kenë dhe përmbajtjen e ruajtjes dhe promovimit të vlerave.

Z. Veton Nurkollari nga DokuFest, përgëzoi organizatorët për iniciativën dhe hulumtimin e përgaditur duke u fokusuar në pikën e financimit të organizatave të pavarura kulturore. Sipas tij, brenga më e madhe duhet të jetë që sipas hulumtimit 80% e këtyre organizatave ende financohen nga donacionet e huaja, e që ky është një moment shumë i mirë që komuna dhe institucionet tjera vendore dhe të gjithë akterët e kulturës të vetëdijësohen që fondet vendore për kulturë duhet të rriten dhe se kultura vecanërisht në Prizren është faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik.

Z. Bahri Zenelaj nga ATTA, pasi që përgëzoi OJQ-në EC Ma Ndryshe për iniciativën, potencoi se nga hulumtimi i bërë si dhe nga diskutimet në debat mund të konkludohet së paraqitet nevoja urgjente për të hartuar një strategji të kulturës ose më konkretisht një plan veprimi i cili do të aprovohet në asamblenë komunale e cila do ti obligonte asambleistët për implementimin e saj.

Para mbylljes së debatit **Z. Çeku** e ktheu fjalën përsëri në panel duke fillur me Z. Haxhibeqiri për një reagim të përgjithshëm pas tërë diskutimit. Sipas Z. Haxhibeqiri, hulumtimi i bërë me organizatat e kulturës do ti ndohmojë shume Rrokut për të arritur objektivin kryesor të tij që është hartimi i politikave kulturore në Komunën e Prizrenit.

Z. Arënliu në fjalën e tij përmbyllëse tha se në bazë të diskutimit po vërehet një energji pozitive në mes të organizatave të bashkuara në rrjetin Rrok që problemet ekzistuese në nivelin lokal të adresohen në mënyrë sistematike qoftë me strategji apo me dokument të caktuar që sistemon veprimet që duhet ndërmarë. Sipas tij, rezultatet e hulumtimeve po reflektojnë një kapacitet bazik për të bërë një hap më tutje në drejtimin e zhvillimit të politikave publike kulturore, por në të njëjtën kohë edhe mangësitë e shumta që ekzistojnë në organizata e cilat duhet të analizohen në kuadër të Rrok-ut.

Z. Hajrulla Çeku përmbylli debatin duke falenderuar të gjithë pjesëmarrësit e debatit e vecanërisht Z. Arënliu për hulumtimin, komentimin e rezultateve dhe bashkëpunimin me OJQ-n EC Ma Ndryshe. Poashtu falenderoi edhe Z. Haxhibeqiri si koordinator të Rrok-ut i cili tani është përfaqësues i sektorit të kulturës për pjesën e koordinimit e cila është shumë e nevojshme për profilizimin e Rrok-ut dhe ngritjen e vizibilitetit të tij.

Politikat e Financimit të Kulturës në Nivel Lokal

Besar Haxhibeqiri, hapi zyrtarisht debatin duke prezentuar panelistët e debatit dhe duke falenderuar ata dhe të gjithë pjesmarrësit që kishin shprehur interesim të merrnin pjesë në këtë debat. Ai po ashtu potencoi edhe temën e diskutimit të këtij debate që ishte : Politikat e financimit të Kulturës në nivel lokal.

Panelistët e debatit ishin:

Znj. Vjollca Aliu – Drejtoreshë e Departamentit i Trashëgimis Kulturore në MKRS

Z. Ruzhdi Rexha – Nënkyetar i Komunës së Prizrenit

Z. Sali Shoshi – Drejtor në “Trashëgimia Kulturore pa Kufijë – CHWB”

Z. Bahri Zenelaj – OJQ “ATTA” – Prizren

Para se të fillonte debati fjalën e mori Z. Hajrulla Çeku nga EC Ma Ndryshe, për të njoftuar pjesmarrësit për debatin dhe qëllimin e projektit në kuadër të të cilit po zhvillohej debati.

Z. Hajrulla Çeku, tregoi shkurtimisht përmbajtjen e projektit, aktivitetet dhe të arriturat e projektit deri në këtë datë. Gjatë fjalimit ai përmendi debatin e parë që ishte zhvilluar gjatë muajit Dhjetor të vitit të kaluar, duke treguar se gjatë atij debatit ishin prezentuar të gjeturat preliminare të hulumtimit i cili është duke u zhvilluar në kuadër të këtij projekti. Ai vazhdoi duke treguar qëllimin e hulumtimit i cili është “Involvimin e qytetarëve të Prizrenit, shoqërinë civile, komunitetin e kulturës në qeverisjen lokale, konkretisht në sektorin e kulturës,” si dhe qëllimin kryesor të projektit i cili është “Qyteti i Prizrenit të ketë politika kulturore që kultura të shfrytëzohet për qëllime zhvillimore të qytetit, sepse ne e konsiderojmë kulturën si njërin prej resurseve më të rëndësishme zhvillimore ose edhe resursi më i rëndësishëm i komunës.” Z. Çeku, bëri një përmbledhje të rezultateve të hulumtimit ku tregoi se këto rezultate kanë dhënë një pasqyrë të orientimit, besimit dhe mendimet e qytetarëve të Prizrenit mbi kulturën, por në të njëjtën kohë edhe një pasqyrë lidhje me sektorin e kulturës së pavarur në Prizren. Ndër të tjera, ai përmendi dhe faktin që Komuna e Prizrenit për kulturë ndanë buxhet rreth 1 euro për kokë banori e që kjo tregon që nga aspekti financiar, qytetin e Prizrenit nuk mund ta quajmë qytet të kulturës.

Z. Ruzhdi Rexha – nënkryetar i Komunës së Prizrenit filloi fjalimin e tij duke treguar se edhe në shtetet e zhvilluara perëndimore sektori i kulturës ballafaqohet me vështirësi në aspektin e financimit, e që aktivitetet kulturore gjithmonë kanë konkurrencë nga aktivitetet tjera siq janë infrastruktura, arsimi, ambienti dhe shumë aktivitete tjera. Sipas tij, duke ditur që buxheti i Kosovës në përgjithësi dhe i Komunës së Prizrenit në veçanti nuk është i mjaftueshëm atëherë nënkuptohet që është e domosdoshme që të kërkojmë fonde shtesë nga sponzorët ose donatorët e ndryshëm. Ai poashtu pohoi se arti dhe kultura nuk janë në prioritet të zhvillimit nacional dhe lokal, por me ngritjen e rolit të kulturës duke përfshirë edhe debatin do të arihet që investimet në kulturë të jenë më të larta. Ai vazhdoi fjalimin e tij duke dhënë detaje të buxhetit komunal për kulturë ku sipas tij prej viti 2010-2012 buxheti komunal për kulturë është afërsisht rreth 1 Milion euro prej të cilave 880 mijë ndahen për investime kapitale ndërsa 115-134 mijë për aktivitetet e ndryshme kulturore, rinore dhe sportive të cilat organizohen në Komunën e Prizrenit. Në anën tjetër ai bëri të ditur se në

debatet publike të organizuara na komuna për temat e ndryshme interesimi më i vogël është treguar për sektorin e kulturës ndërsa interesimi më i madh për sektorin e infrastrukturës.

Z. Sali Shoshi – CHwB, filloi duke shpjeguar formimin e organizatës të cilën ai përfaqëson CHWB, organizatë kjo e cila është formuar në vitin 1996 nga disa organizata suedeze që mirreshin me trashëgimi kuturore, e formuar për një kauzë e cila ishte mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Bosnje dhe Hercegovinë pas mbarimit të luftës. Ndërsa në Kosovë kjo organizatë kishte filluar punën e saj në vitin 2000, me c’rast kishe disa fonde që i dedikoheshin trashëgimisë kulturore dhe njëri prej fondeve ishte prej Agjencionit Evropian për Rindërtim i cili kishte ndarë fond për restaurimin e 5 kullave me tipologji të ndryshme, por kishte fonde edhe prej qeverisë suedeze. Ai poashtu shpjegoi se si organizata pasi që përfundoi periudha e mobilizimit në vitin 2000 dhe fondet emergjente në fushën e trashëgimisë, me faktin që kultura e as trashëgimia kulturore nuk ishin prioritet të zhvillimit, ndodhi një lëvizje mes asaj që qëllimi kryesor ishte restaurimi e në fakt nuk është restaurimi por zhvillimi në përgjithësi duke përfshirë zhvillimin ekonomik, të drejtat e njeriut dhe qeverisja e mirë. Një prej fakteve është përfitimi prej IPA-s, e që organizata raporton për zhvillim ekonomik mirëpo ajo realizon projekte kulturore. Shembull konkret ishte intervenimi në 20 shtëpi tradicionale të cilat do të bëhen bujtina e që pas intervenimeve do të shndërrohen në 20 biznese të vogla të cilat do të bëjnë punësimin e 20 personave. Sipas tij, ky dhe projekte tjera të organizatës që lidhen me aspekte të ndryshme të jetës së qytetarëve dëshmojnë se kultura është një prej faktorëve kryesor të zhvillimit të vendit në tërësi.

Z. Bariu Zenelaj – ATTA, fokusoi fjalimin e tij në pasojat të cilat vijnë me faktin që kultura nuk është prioritet në asnjërin nivel të udhëheqjes. Sipas tij mungesa e një fondi të posaqëm me anë të të cilit do të mbështeteshin iniciativat dhe aktivitetet kulturore bën që shumica e organizatave të varen prej fondeve e donacioneve të ndryshme të huaja, të cilat shumë shpesh rezultojnë në organizimin e aktiviteteve të jenë improvizime kulturore e jo aktivitete kualitative. Ai në fund sugjeroi se në këtë fushë si shembuj duhet të mirën disa shtete rajonale të cilat për zhvillimin e kulturës jo formale kanë krijuar fonde të posaqme dhe pastaj kanë përcaktuar mënyrat se si bëhet ndarja brenda sektorit të kulturës.

Znj. Vjollca Aliu - Drejtoreshë e Departamentit të Trashëgimis Kulturore në MKRS, foli për institucionet vartëse që ka Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve në nivel qendror dhe nivel lokal. Ajo tregoi për një fond që e jep kjo ministri përmes granteve të ndryshme ku të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat, individët dhe institucionet edhe pse ky fond nuk i përmbushë nevojat dhe kërkesat aq sa duhet. Në përmbyllje të fjalës së saj ajo shprehi gadishmërinë e nivelit qendror për hartimin e politikave kulturore në nivel lokal ku edhe pjesmarrja e qytetarëve dhe aktivitetet e organizatave tjera në hartimin e këtij dokumenti do të ishte shumë i vlefshëm.

Pas fjalimeve të panelistëve Z. Haxhibeqiri ftoi pjesmarrësit në debat të hapur

Z. Afrim Avdaj – shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në Kuvendin Komunal Prizren, ishte i mendimit se ky debat duhet të fokusohet në dy drejtime: 1) cka ka bërë Kuvendi Komunal dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që kultura si element i rendësishëm i jetës së qytetarëve, qeverisjes dhe element qenësor i asaj që zhvillohet në përgjithësi? Më këtë rast ai tregoi se Kuvendi Komunal për herë të parë ka miratuar një strategji të hartuar nga drejtoria e kulturës dhe ka

përcaktuar mekanizmat se si mund të implementohen prioritetet e gjithë atij aktiviteti kulturor, e në të cilën strategji përfshihen edhe mënyrat e financimit të projekteve, dhe 2) Grupi parlamentar i PDK-së në Kuvendin Komunal Prizren është i kënaqur me gjendjen e kulturës në qytet dhe sipas tij gjendja e kulturës në Prizren duhet të shihet me gjendjen e përgjithshme jo vetëm të kulturës por edhe të shëndetësisë, arsimit dhe fushave në shtetin tonë duke përfshirë gjendjen sociale në vend. Ai përmbylli komentin e tij duke i bërë apel organizatës EC Ma Ndryshe që të vëjë kontakte me drejtorinë e kulturës edhe me legjislativin e komunës dhe grupin parlamentar të cilin ai përfaqëson në mënyrë që të përmirsojnë kualitetin e jetës së qytetarëve të Prizrenit dhe përmirësimin e jetës kulturore në qytet.

Z. Nysret Durmishi - Nënkryetar i Bashkimit Demokratik – në komentin e tij potencoi se trashëgimia kulturore në Prizren dhe fakti që Prizreni është qytet i kulturës janë vetëm elemente në bazë të të cilave keqpërdoret qyteti në kohë të fushatave. Sipas tij, qeveria lokale nuk është aspak e interesuar të investojë në zhvillimin e kulturës dhe se ajo konsideron investim në kulturë blerjen e një bine shumë të shtrenjtë e cila vite me radhë nuk futet në përdorim e me këtë shembull përmendi dhe shumë raste tjera që sipas atij ishin qasje destruktive ndaj investimit në kulturë. Tjetër mangësi sipas tij është bashkëpunimi dhe komunikimi mes institucioneve lokale dhe OJQ-ve, i cili zhvillohet në mënyrë formale por janë raste të ralla ose inekzistente kur komuna merr parasysh dhe plotëson kërkesat e këtyre OJQ-ve.

Znj. Marte Prekpalaj - Shoqata Femra Vizionare e shek 21, tregoi për shumë objekte të trashëgimisë kulturore në zonat rurale dhe për të cilat nuk është bërë asgjë nga institucionet lokale. Me këtë rast ajo bëri apel që mos ti kushtohet rëndësi vetëm qytetit por edhe zonave rurale ku ka shumë pasuri kulturore dhe të trashëgimisë kulturore, dhe të mërren masa për shpëtimin e objekteve që janë shkatërruar.

Znj. Gjejlane Hoxha – Udhëheqëse ekzekutive e Keshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ceki se nuk mund të ndërtohen politika kulturore pa pasur analiza të cilat do të jnë pjesë përbërëse e planit zhvillimor komunal ku përfshihen edhe zonat rurale e jo vetëm resurset dhe nevojat e mjediseve jetësore të qyteteve. Sipas saj, kultura nuk duhet të jetë në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe se ajo së pari duhet të zhvillohet për mirëqenien e qytetarëve. Ajo poashtu theksoi se strategjia për kulturë e miratuar në vitin 2003 nga Kuvendi i atëhershëm nuk është marrë parasysh nga asnjë ministër i kulturës deri më tash. “Kulturën duhet ta pozicionojmë si objektiv zhvillimor nacional”, shtoi ajo. Sa i përket financimit të kulturës, ajo tha që në Kosovë nuk ka politika fiskale të cilat na orientojnë për funksionimin e mënyrës së financimit të kulturës. Ajo bëri disa propozime të cilat ajo konsideron që duhet të mirren parasysh e që ishin: mungesa e politikës nacionale, ekzistimi i strategjisë nacionale që kurrë nuk është zbatuar, themelimi i fondit nacional për zhvillimin e kulturës dhe themelimi i instituti për zhvillimin e kulturës në nivelin nacional.

Z. Blerim Bytyqi – Orkestra e qytetit të Prizrenit, bëri pyetjen për gjithë pjesëmarrësit së kush prej të pranishmëve dinte për ekzistencën e kësaj orkestre e prej këtij fakti të konkludojnë se sa dijnë ata për punën e njëri tjetrit dhe sa janë të gatshëm të ndihmojnë njëri tjetrin. Ai bëri thirrje për të gjithë që të afrohen sa më shumë me njëri tjetrin dhe të bashkëpunojnë e poashtu ta përkrahin edhe orkestrenë e Prizrenit e cila është e përbërë nga profesionistë të cilët nuk kanë kurfar përkrahje tjetër përpos asaj morale. Sa i përket strategjisë, ai tha që nuk është e rëndësishme se kush është përgjegjës për këtë por duhet të shfrytëzuar vullnetin e mirë të komunitetit për të zhvilluar një strategji.

Z. Eroll Bilibani – DokuFest, ishte i interesuar të dinte për praktikat aktuale të përdorura nga komuna e Prizrenit për financimin e kulturës, ose edhe ndonjë praktikë rajonale e cila mund të muret si shembull i mirë e të praktikohet nga komuna e Prizrenit dhe se a ka ndonjë mënyrë të evaluimit apo monitorimit të aktiviteteve ose ngjarjeve kulturore të cilat financohen nga komuna që të ketë ndonjë kriter për ndarjen e këtyre subvencioneve?

Z. Ruzhdi Rexha, në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga Z. Bilibani iu referua raporteve financiare të komunës për kulturën. Duke u bazuar në atë raport ai renditi të gjitha festivalet të cilat cdo vit financohen nga komuna si dhe shumën e ndarë për ato festivale, e ato ishin: 1) Hasi Jehon (3000 euro), 2) Festivali Fluturat (3500 euro) 3) Zambaku i Prizrenit (5000 euro) 4) DokuFest (5000 euro) etj. Ndërsa shpërndarja bëhet duke u bazuar në mënyrën e financimit të viteve paraprake, dmth janë financuar me vite dhe vazhdojnë të financohen edhe pse ndërkohë po paraqiten festivale të reja të cilat duhet të vlerësohen dhe të financohen.

Z. Nexhip Menekshe – Durmish Asllano, shprehi disa shqetësime të tij sa i përket organizimit të aktiviteteve të organizatës e që kishin të bënin me anën financiare ku ai duhet të paguaj sallën e kulturës dhe nxemjen dhe duhet të paguajë çmimin e njejtë në rast se duan ta japin dhe reprizën. Shqetësimi i dytë ishte që ata nuk mundën me përfaqësu Kosovën jashtë Kosovës dhe mbesin vetëm në Prizren me atë aktivitet sepse Ministria e Kulturës nuk i financon me arsyetimin se e kanë harxhuar buxhetin e caktuar.

Znj. Vjollca Aliu, mori fjalën për të shtuar që ndoshta mënyra më e mirë për të përmirësuar gjendjen e tanishme si në nivel lokal edhe në atë qendror, po edhe për t'ju lehtësuar punën organizatave të ndryshme dhe institucioneve është që të ketë një koordinim sa më të mirë në mes të gjithë këtyre aktereve në këtë fushë.

Z. Hajrulla Çeku, kishte dy konstatime në bazë të diskutimit që u zhvillua paraprakisht. E para ishte qasja e komunës e cila nuk dallon edhe aq shumë nga ajo e Ministrisë së Kulturës ndaj zhvillimit kulturor dhe ndaj sektorit të pavarur, është se ato e shohin zhvillimin kulturor përmes dy drejtimeve; ndërtimi i objekteve kulturore sportive dhe financimi i disa festivaleve ose aktiviteteve tjera kulturore, përderisa qëllimi më i këtyre projekt është me e ndryshu këtë qasje të vjetër burokratike. Ai shtoi se gjatë diskutimi u vërejt se ka tendencë që të konstatohet fakti që kur kultura nuk është e zhvilluar sepse aspektet tjera “më të rëndësishme” të jetës nuk janë të zhvilluara në vend, prap qasje e vjetër burokratike, sipas Z. Çeku. Ai përmbylli komentën e tij duke thënë se qëllimi kryesor është që kultura të mos jetë barrë e zhvillimit komunal e nacional por të jetë një ndër shtyllat kryesore të këtij zhvillimi.

Z. Parim Kosova, filloi fjalimin duke treguar për objektin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe frekuentimit që i bëhet atij objekti nga turistët e vendeve të ndryshme, për të vazhduar të tregoj eksperiencën e tij me mungesën e donacioneve potenciale nga donatorët e jashtëm. Ai përfundoi duke kërkuar nga pjesëmarrësit që ta përkrahin dhe ta ndihmojnë sa i përket donacioneve.

Z. Bahri Zenelaj, shtoi se në momentet kur ka vakum institucional në nivel lokal ose nacional organizatat e shoqërisë civile janë ato të cilat mundohen të gjejnë fonde/donacione për ta mbajtur kulturën në nivelin e duhur. Në anën tjetër, ai qartësoi se nuk mendon që këto organizata duhet të dalin nga misioni ose trajta e tyre dhe të anashkalojnë institucionet shtetërore.

Z. Demir Zekolli - Menaxher i Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Therandës, filloi fjalimin e tij duke e vënë në pah një ndryshim të roleve ose pozicioneve në mes të institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile. Sipas tij, do të ishte më mirë që këto lloj debate për kulturën në përgjithësi dhe trashëgimin kulturore në vecanti të organizoheshin nga Ministria përkatëse dhe komunat si dhe ato të jenë subjekte pjesëmarrëse. Ai vazhdoi fjalimin e tij duke marrë shembull komunën të cilën përfaqësonte, me ç'rast tregoi që ky sektor ekziston në Therandë që nga viti 2003 i cili funksionon në mënyrë aktive dhe që ka dhënë rezultate konkrete pa mbështetjen e të tjerëve dhe investimet që janë bërë nga vetë komuna.

Konsumi dhe Oferta Kulturore në Prizren

Z. Besar Haxhibeqiri, hapi zyrtarisht debatin duke prezentuar panelistët e debatit dhe duke falenderuar ata dhe të gjithë pjesëmarrësit që kishin shprehë interesim të merrnin pjesë në këtë debat. Ai po ashtu potencoi edhe temën e diskutimit të këtij debati që ishte: Konsumi dhe Oferta Kulturore në Prizren

Panelistët e debatit ishin:

Z. Zekë Çeku – ekspert për turizëm

Z. Urim Ukimeri – koordinator për kulturë në Drejtorinë Komunale në Prizren

Z. Veton Nurkollari – drejtor artistik i DokuFest

Para se t'u jipte fjalën panelistëve, Z. Haxhibeqiri tregoi në pika të shkurta qëllimin e projektit dhe serisë së debateve që janë organizuar në kuadër të këtij projekti. Ai potencoi se qëllimi kryesor është ta nxisë qeverinë lokale që kulturën ta shoh si burim strategjik të zhvillimit si dhe të promovojë pjesëmarrjen qytetare në hartimin e zbatimin e politikave kulturore. Ai poashtu në cilësinë e kordinatorit të Rrjetit të Organizatave Kulturore në Prizren – Rrok, përmendi se ky rrjet i ka dy aktivitete themelore që në të njëjtën kohë përputhen me Konsumin dhe Oferten Kulturore në qytet e që janë; Kalendar Kulturore i cili është duke u përpiluar në bashkëpunim me të gjitha organizatat anëtare të rrjetit i cili synon të ndihmojë zhvillimin lokal të Prizrenit, strukturimin dhe promovimin të ofertës kulturore të qytetit. Ndersa, aktiviteti tjetër është përgaditja e një pakoje turistike e cila poashtu do të jetë një burim tërheqës për turistat. Pas këtyre fjalëve ai i japi fjalën Z. Zekë Çeku-t.

Z. Zekë Çeku - ekspert për turizëm dhe ligjerues i lëndëve të turizmit në universitet, shprehi mirënjohjen e tij për përgaditjen e kalendarit kulturore për qytetin e Prizrenit që sipas tij do t'u ndihmojë shumë agjencioneve turistike për të informuar turistët për eventet që ndodhin në qytet. Sipas tij, kultura është njëra prej dy shtyllave kryesore në të cilat qëndron produkti turistik në përgjithësi duke ditur që ky produkt qëndron në trashëgiminë kulturore dhe në atë kulturore. Duke pasur parasysh diversitetin e trashëgimisë kulturore, ai ishte i mendimit që qyteti i Prizrenit ka një sjellje qytetruese ndaj trashëgimisë kulturore të cilën nuk e kanë qytetet tjera, duke konkluduar se qytetet tjera e kanë humbur fare këtë sjellje qytetëruese. Një problem të cilin ai potencoi ishte mungesa e informatave të mjaftueshme për tursitët që vinin në Prizren duke cekur se edhe ato informata që kanë janë prej burimeve terciare. Problem tjetër sipas tij është edhe mungesa e një orari të caktuar për vizitë të monumenteve të caktuara në Prizren, duke theksuar Hamamin që sipas Z. Çeku, është shumë e vështirë të bëhet vizita e Hamamit të qytetit sepse duhet telefonuar njerëz të caktuar që të mundësojnë hyrjen në te. Ai përmbylli fjalimin e tij duke bërë apel tek qytetarët që të kenë kujdes me hedhurinat dhe mos ti lënë ato nëpër rrugë të qytetit.

Z. Urim Ukimeri – Kordinator i kulturës në komunën e Prizrenit, filloi fjalimin e tij me disa të dhëna për ngjarjet kulturore që ndodhin brenda vitit në qytetin e prizrenit e që sipas tij janë diku rreth 60-70 ngjarje shumica e të cilave ndodhin gjatë muajve Maj – Qershor – Korrik. Sipas tij, edhe pse ka pasuri të madhe kulturore dhe natyrore duhet të bëhet një punë më e madhe dhe përkujdesje më e madhe për të bërë eksploatimin e këtyre pasurive në funksion të rritjes ekonomike të qytetit. Ai

vazhdoi fjalimin e tij duke përmendur pengesat ose vështirësit në këtë drejtim, duke vuar theksin në vetëdijësimin e qytetarëve sa i përket vlerave të trashëgimis kulturore, qasja në objektet e trashëgimis kulturore ortodokse që sipas tij qasja në këto objekte nuk është gjithëhere e lehtë dhe se as instituti për mbrojtjen e monumenteve nuk ka qasje në ato objekte. Si problem tjetër ai sheh mos kordinimin e institucioneve lokale me shoqërinë civile dhe institucionet qendrore. Sipas Z. Ukimeri, nuk duhet anashkaluar faktorët neglizhues dhe mospërfillës në përkrahjen e pamjaftueshme të krijimtarisë së mirëfillit artistike, rolin e pamjaftueshëm të kulturës në jetën e qytetarëve si dhe apatinë e qytetarëve kundrejt trendit degradues të jetës kulturore. Ai mbylli fjalimin e tij duke rikujtuar që komuna e ka një dokument orientues për zhvillimin kulturorë i cili mund të shërbejë si pikënisje në hartimin e strategjive kulturore, sipas tij ky dokument parasheh bashkëpunim me fusha tjera sic janë trashëgimia kulturore e natyrore, turizmi kulturor, planifikimi hapësinor, zhvillimi ekonomik.

Z. Veton Nurkollari – Dokufest, duke mos dashur të flas shumë për qytetin e Prizrenit, ai vuri theksin e tij në potencialin pothuajse të vetëm zhvillimor i cili sipas tij është turizmi kulturor që zhvillohet në Prizren. Ai apeloi komunën për dy gjëra; që ajo të kuptoj që burimi më i madh i zhvillimit ekonomik në komunë është kultura dhe në anën tjetër që komuna të konsideroj Rrok-un si partner strategjik dhe të barabart në hartimin e strategjive afatgjate për kulturë. Ai vazhdoi fjalimin e tij duke thënë që më një punë ose organizim të mirëfillt mund të arrihet gjithcka e sidomos në fushën e kulturës dhe këtu si shembull mori DokuFest-in gjatë të cilit Prizreni vërshohet nga një numër i madh të turistave. Ai përmbylli fjalimin e tij duke përgëzuar Z. Çeku-n për punën e tij në sjelljen e turistave e sidomos atyre Japonez në Prizren, duke cekur se qyteti mund të përballoj shumë më shumë turista dhe për këtë duhet të shfrytëzuar sa më shumë potenciali ekzistues i qytetit.

Pas fjalimeve të panelistëve Z. Haxhibeqiri i ftoi pjesëmarrësit në debat të hapur.

Z. Qazim Thaqi – TV Besa, nuk u pajtua me përdorimin e shprehjeve që po bëhen për kulturë si “konsumi dhe oferta”, pastaj vuri në dukje mungesën në debat të personave përgjegjes për turizmin nga komuna dhe për të përfunduar me përbërjen e Rrok-ut sipas të cilit në atë rrjet ka organizata të peshkatarëve e bjeshkatarëve të cilët nuk merren aspak me kulturë ndërsa ka organizata që merren me kulturë e trashëgimi kulturore e nuk janë pjesë e Rrok-ut.

Z. Çeku bëri shpjegimin e fjalës konsum dhe turizmit kulturor duke thënë se turizmi, vizita e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, vizita e monumenteve etj janë gjëra që konsumohen në mënyrë të ripërtrishme, pra është e pamundur të konsumohen në kuptimin e plotë të fjalës, ai poashtu shpjegoi që ekzistojnë disa lloje të turizmit dhe patjetër që duhet përdorur terma si turizëm kulturor apo turizëm malor etj.

Në anën tjetër **Z. Nurkollari** bëri një replikë sa i përket përfshirjes së organizatave të bjeshkatarëve ose peshkatarëve në Rrok duke potencuar se, sipas tij të gjitha organizatat apo shoqatat kanë të bëjnë me kulturë, dhe u përkujtoi pjesëmarrësve se shoqata e bjeshkatarëve të Prizrenit ka hypur në majen Kilimanxharo me flamur të Kosovës, dhe konsideroi që ai akt ka të bëjë me turizëm kulturor dhe kulturën në përgjithësi.

Z. Blerim Bytyqi – Orkestra e Qytetit të Prizrenit, filloi duke thënë se është koha e fundit që kultura dhe turizmi kulturor të shihen si burimet kryesore të zhvillimit në qytet. Ai theksoi se është e rëndësishë së madhe vendi i objekteve të caktuara kulturore, që ato të jenë në qendër dhe ne pjesë ku frekuentohen prej qytetarëve dhe turistave, dhe pika tjetër e tij ishte mungesa e ciceronit në qytetin e Prizrenit. Ai vazhdoi duke thënë se opcion shpëtimtar për komunën e Prizrenit është turizmi kulturor e zhvillimi i këtij arihet me një organizim logjistik, fizik e mendor.

Z. Munir Basha – Partia Konservatore dega në Prizren, ishte i mendimit që komuna e Prizrenit si institucion, nuk është e vetëdijshme për potencialin që ka kultura dhe turizmi kulturor për të ofruar në të mirë të zhvillimit të komunës në Përgjithësi, duke mos harruar të përmend mungesën e drejtorisë së turizmit në debatin që po zhvillohej e cila pasqyron qasjen e komunës në këtë aspekt.

Z. Sadik Paçarizi - Drejtorja e urbanizmit në komunën e Prizrenit - listoj objektet e restauruara nga kuvendi komunal. Ai përmendi edhe partneritetet e lidhura me shoqërinë civile për përdorimin/funksionalizimin e Qendrës Europa, e këto partneritete janë lidhur me DokuFest ku prej të cilit kërkohet funksionalizimi sa më i shpejtë i kinemasë, për herë të parë pas luftës në Prizren. Po ashtu ai përmendi edhe partneritetin me shoqatën e zejtarëve të cilës u janë dhënë 4 lokale brenda qendrës Europa, lokale këto të cilat duhet t'ju shërbejnë aktiviteteve të trashëgimis kulturore, traditës së Prizrenit në veshjet tradicionale, zejjet te ndryshme dhe kështu të tërhiqen shumë turist. Ai apeloj tek shoqëria civile që të ofrojnë ide shumë konkrete dhe të prekshme për ti kthyer Prizrenit vlerat e veta kulturore që i ka.

Z. Ceku morri fjalën për të thënë së është më së nevojshme që komuna të ketë organin e menaxhimit të destinacionit ku marrin pjesë të gjithë aktorët si; Rrok-u, EC Ma Ndryshe, Drejtorja për zhvillim dhe Ekonomi, Teatri, Orkestra etj. Roli i këtij organi do të shërbente në ndërtimin e planit strategjik të turizmit për komunë si dhe për sjelljen e turistave këtu.

Z Haziz Hodaj – Drejtor i festivalit Has Jehon, replikoi drejtorin e Urbanizmit duke potencuar se tek qendra Europa për të cilën foli drejtori ka aq shumë pa rregullsi dhe mbeturina sa që mjaftojnë për të treguar sa se jemi të vetëdijshëm për vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore që kemi. Po ashtu sa i përket qendrës Historike të Prizrenit, Z.Hazizi tha “ajo jo që nuk është ruajtur por është dhunuar në mënyrë më të vrazhdë të mundshme dhe sot e kemi një gjendje kaotike në pjesën më të mirë të qytetit.” Ai poashtu akuzoi institucionet lokale për injorancën sa i përket restaurimit të kalasë, njëra prej elementeve me të cilën identifikohet qyteti i Prizrenit. Ne fund ai apeloj tek të gjithë që të bëjnë sa më shumë për ruajtjen e vlerave ekzistuese si ato te trashëgimise kulturore dhe të kulturës në përgjithësi.

Znj. Ajtene Krasniqi – shoqata e zejtarëve dhe afaristëve të Prizrenit, fillimisht potencoi vlerat e qytetit dhe kapaciteteve që ai posedon në fushën e kulturës dhe apeloj tek të gjithë për angazhim më të madh për të bashkëpunuar më shumë në mënyrë që qyteti të zhvillohet. Ajo mori si shembull qytetet e zhvilluara si Kan dhe Holieood për investimet që ata bëjnë për organizime të eventeve dhe aktiviteteve kulturore. Në të njëjtën kohe, ajo shprehi mirënjohje për iniciativën që ka ndërmar Rrok-u për hartimin e pakos turistike dhe kalendarin kulturor. Ajo ftoi të gjithë duke përfshirë zejtarët, shoqërinë civile, institucionet, bizneset etj, që të involvohen dhe ndihmojnë organizimet e aktiviteteve kulturore.

Z. Ruzhdi Rexha – nënkryetar i Komunës së Prizrenit, mori fjalën për të informuar pjesëmarrësit që komuna është duke e hartuar strategjinë komunale për turizëm e poashtu edhe iniciativën e

komunës në bashkëpunim me organizatat kulturore që Prizreni të përfshihet në UNESCO bashk me qytetin e Berat-it dhe qytetin e Gjirokastrës.

Z. Abdullah Thaqi – dega e LDK-s në Prizren, shprehi falenderim për ftesën në debat duke e konsideruar shumë të vlefshëm debatin në përgjithësi si dhe pjesëmarrjen e Z. Ceku në panel, si njëri prej njerëzve më kompetent për turizëm në Kosovë. Ai poashtu si dukuri negative ceki mospjesëmarrjen e drejtorit të Drejtorisë për Turizëm e as drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, duke pasur parasysh që këto ishin temat e diskutimit në debat dhe tema që janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Prizrenit. Ai vlerësoi si jo funksionale Drejtorinë e Turizmit së bashku me qendrën për Informim të turistëve, pasi që sipas tij, ajo qendër është brenda drejtorisë dhe punon nga e Hëna deri të Premtën ndërsa fluksi më i madhë i turistëve është gjatë ditëve të vikendit dhe ata nuk ka se kush ti orientoj. Sipas tij, Prizreni nuk mund të ketë ofertë kulturore pas miratimit të ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe me këtë rast fuqizimit të kishës ortodokse serbe.

Z. Xhevdet Doda – aktor profesional, u fokusua në tri pika që sipas tij janë relevante me temën e debatit. Ai filloi me kalendarin kulturor që sipas tij është një aritje e madhe dhe i cili meriton vëmendje sepse në saje të tij ne do të jemi në dijeni çdo moment se çfarë ngjarje kulturore do të ndodhin gjatë vitit në Prizren. Ndër të tjera ai potencoi se në asnjërin prej mediave lokale; televizion ose radio, nuk ka guida ditore të cilat kishin me tregu se çfarë aktivitete do të ndodhin gjatë ditës, e poashtu përmendi që struktura udhëheqëse nuk merr pjesë në aktivitete kulturore e që në fakt ata duhet të jenë shembull për qytetarët që të marrin pjesë në këto aktivitete. Dhe në fund ai kaloi tek çështja e vizitës së nxënësve që e vizitojnë Prizrenin në kuadër të ekskurzioneve e që në fakt e kalojnë tërë ditën në Prizren pa asnjë agjendë dhe të cilët nuk vizitojnë objektet e rëndësishme kulturore, kjo si pasojë e mos koordinimit të organizatorit me Drejtorinë e Arsimit ose të operatorëve kulturorë që nuk janë në gjendje ti shoqërojnë ata nxënësia. Sipas tij këto janë arsye pse nuk mund të konsumohet oferta kulturore që e posedon Prizreni. Me këtë rast ai iu drejtua nënkryetarit të komunës Z. Rexha, që ta kenë parasysh këtë fakt.

Z. Veton Nurkollari, tha se është rezik që edhe Qendra Europa mund të mbetet objekt i zbrazët si shumë objekte tjera të qytetit. Ai tha se muret e objekteve nuk mjaftojnë si ofertë kulturore, atyre duhet tu jipet shpirt e shpirtin duhet t'ja japin organizatat e ndryshme dhe qytetartët ngase komuna nuk ka kapacitete dhe asnjëher nuk ka pasur dhe nuk duhet ta kete, ajo duhet të ndihmojë që kultura të zhvillohet. Ai tregoi se DokuFest-i si partner në Qendrën Europa kanë kërkuar nga kryetari i komunës që ti ndaj 40.000 euro për 18 muajt e ardhshëm për aktivizimin e asaj qendre, e tek ne as aq vizion nuk ka që të ipen 40.000 euro që të funksionalizohet një qendër për të cilën janë investuar mbi 1 milion euro. Ai poashtu potencoi se të gjitha organizatat kulturore edhe Rrok-u janë të hapur për bashkëpunim në këtë çështje, mirëpo nëse prap refuzohen nga kryetari i komunës atëherë nuk mund të flasim për partneritet.

Z. Blerim Bytyqi, ngriti çështjen se si do të jenë pjesë aktive e kalendarit kulturorë trupat artistike profesioniste nese nuk paguhen sepse puna e profesionisteve paguhet?

Z. Veton Nurkollari, poenta e kalendarit kulturorë është që të promovoj ngjarjet kulturore që ndodhin në qytet dhe Rrok-u nuk do të prodhoj asnjë kontratë ngase qëllimi kryesor është informimi i publikut.

Kultura në programin e partive politike në Prizren

Z. Hajrulla Çeku - drejtor ekzekutiv EC Ma Ndryshe, uroi mirëseardhje pjesëmarrësve në debatin e fundit të serisë së debateve në kuadër të projektit Politikat Kulturore duke bërë një përmbledhje të të gjitha aktiviteteve të projektit. Ai njoftoi pjesëmarrësit se këto debate/diskutime janë transmetuar në mediat lokale si dhe janë në formë të raporteve të shkruara, poashtu ai përmendi se në kuadër të këtij projekti është duke u përgaditur edhe një dokumentar, e krejt këto materiale, në fund do ti bashkangjiten raportit përfundimtarë dhe ti dërgohen komunës si një udhëzues konkret se si duhet të dizajnohen politikat kulturore në nivel lokal me disa specifika që ata i konsiderojnë si të rëndësishme. Në fund ai bëri të ditur se në debat do të diskutohej për orientimet dhe bindjet e partive politike në Prizren për kulturën, me pa nëse partitë politike në programet e tyre kanë tejkaluar sentimentin romantik e prezentimit të qytetit si qytet i kulturës dhe për të parë nëse ata kanë plane dhe politika konkrete se si mund ta shfrytëzojmë potencialin kulturor për nevoja zhvillimore.

Z. Çeku sqaroi për ndryshimet që kishin ndodh në panel në moment të fundit si dhe prezentoj panelistët që do të mërrnin fjalën pas tij, e ata ishin;

Znj. Arjeta Nezaj – Lidhja Demokratike e Kosovës

Z. Mensur Bytyqi – Aleanca për Ardhëmirë në Kosovës dhe

Z. Arbër Rexhaj – Lëvizja Vetëvendosje

Znj. Arjeta Nezaj – LDK, tregoi që ka themeluar komitetin për zhvillim dhe turizëm duke ditur që qyteti i Prizrenit është qyteti më i vizituar. Ajo poashtu tha se organizimi i Dokufestit mund të mirret shembull për organizimet tjera që ndodhin në qytet.

Z. Çeku, kërkoi nga Znj. Nezaj nëse ajo kishte mundësi të shpaloste ofertën e LDK-së për kulturën në zgjedhjet e ardhme, pasi që Z. Aziz Hodaj i cili kishte për ta shpalosur programin politik për sektorin e kulturës nuk kishte ardhur në debat?

Sipas **Znj. Nezaj**, oferta e LDK-së është që kur të ndërtohet organogrami të ketë një organizim të mirëfilltë dhe të parashihen programet për të cilat diskutojmë dhe i shohim si prioritet për zhvillimin e turizmit të kulturës, të bëhen broshura ditore, javore, mujore dhe vjetore ku turistët mund të informohen për programet e qytetit të Prizrenit, të angazhohen ciceron të mirëfilltë dhe të jenë profesional dhe të jetë një drejtori e hapur e cila do të bashkëpunoj me komunat tjera si dhe drejtori i kësaj drejtorie të jetë më bashkëpunues me organizatat e shoqërisë civile dhe individë të cilët përkrahin këtë zhvillim që në fakt është pasuri.

Z. Mensur Bytyqi – AAK, para se të elaboronte planin partiak për aspektin e kulturës në Prizren theksoi se deri sot nuk është bërë asgjë për kulturë me arsyetimin se është punuar në fusha tjera më të “rëndësishme,” ai poashtu tha që kultura është elementi më kryesor i zhvillimit të një shoqërie dhe paraqitjes së saj si brenda ashtu dhe jashtë. Në vazhdim ai filloi të elabaroj planprogramin partiak për

kulturën në qytet, prioriteti i parë sipas tij është zhvillimi shumë dimensional i rinisë me theks të vecantë në fushën e kulturës, në këtë mënyrë do të ndërtohej një rini e shëndoshë e cila do ta qoj zhvillimin e kulturës përpara, përfundoi ai.

Z. Arbër Rexhaj – VV, filloi fjalimin e tij duke përmendur neglizhiencën e treguar për debat nga qeveria e tanishme komunale duke thënë se rëndësia që kjo qeveri i jep zhvillimit të kulturës shihet me mos pjesëmarrjen e tyre në këtë debat. Ai vazhdoi fjalimin e tij duke treguar shkurtimisht alternativën qeverisëse të Lëvizjes Vetëvendosje e që ishte: qasja e lehtë e të gjithë qytetarëve në jetën kulturore artistike, mbrojtja e trashëgimisë kulturore të Prizrenit duke e konsideruar këtë trashëgimi si pjesë të pandashme të historisë dhe popullit të Kosovës, ai cekti se Lëvizja mendon që objektet e trashëgimisë kulturore nuk i takojnë asnjë kombi dhe janë të të gjithë atyre që jetojnë në vend. Sipas tij, përpos reforma rrenjësores drejtoria e kulturës do të angazhohet të fitojë përkrahje financiare dhe kjo përkrahje të pasqyroj me rritje të konsiderueshme të buxhetit të kulturës. Strategjinë për punën e kësaj drejtorie Lëvizja Vetëvendosje e kishte ndërtuar mbi zhvillim e një infrastrukture të qëndrueshme kulturore përmes projekteve të tilla si: ndërtimi i hallkave multifunkionale të qendrave artistike dhe të aktiviteteve kulturore, digjitalizimi i trashëgimisë kulturore, ndërtimi i qendrave kulturore artistike, renovimi i qendrave ekzistuese kulturore, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit kulturor, krijimin e programeve përkatëse për nismat e reja, zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të drejtave të autorit, përkrahjen asociacioneve të shkrimtarëve. Ai përfundoi fjalimin e tij duke përmendur faktin që drejtoria e kulturës gjithmonë është parë si jo e rëndësishme pasi që gjatë gjithë kohës ka qenë drejtori e varur prej pazareve politike dhe koalicionëve lokale.

Pas përfundimit të fjalimeve të panelistëve **Z. Çeku** potencioi se në asnjërin prej fjalimeve nuk hasi në idenë se partia në pushtet do të bashkëpunoj me Rrok-un për krijim e politikave kulturore në qytetin e Prizrenit dhe në anën tjetër shprehi optimizmin e tij për të bindur partitë për një bashkëpunim rreth hartimit të politikave kulturore ngase këto politika duhet patjetër të bëhen në bashkëpunim me sektorin e kulturës së pavarur. Pas këtij konstatimi ai i ftoi të gjithë pjesëmarrësit të jenë pjesë e debatit.

Z. Blerim Bytyqi – Orkestra e qytetit të Prizrenit, ishte i mendimit që të gjithë brengoseshin shumë pak për kulturën duke e parë atë vetëm përmes objekteve të paluejtshme të traditës sonë të ndërtuar prej paraardhësve tonë, por sipas tij thelbi kryesor i asaj është sa i bukur dhe i pastër duket qyteti dhe sa janë funksionale ansamblet dhe ngjarjet artistike që sipas tij me organizim pak më të mirë ato mundën me qenë të përditshme. Ai ftoi të gjithë qytetarët që të lejnë anash etiketimet ndaj njëri tjetrit dhe të bashkohen për zhvillimin e kulturës.

Z. Afrim Tejeci - Shoqata e Zejtareve në Prizren, fokusoi komentin e tij mbi bashkëpunimin e tri sferave shoqërore; institucioneve, bizneseve dhe kulturës së pavarur. Ai përmendi disa raste kur kjo shoqatë iu është ofruar institucioneve lokale me projekte konkrete për funksionimin e qendrave të mëhershme zejtare, projekte këto të cilat u panë të paarsyeshme nga institucionet komunale. Ai poashtu ngriti një çështje të rëndësishme sa i përket vizitave të delegacioneve të ndryshme në Prizren ku shoqërimin e këtyre delegacioneve e bëjnë agjensitë nga vendet e huaja të cilat mund të informojnë delegacionet me informata jo të sakta për shkak të njohurive të pa mjaftueshme për kulturën, traditën ose historinë e vendit. Sipas tij kjo çështje duhet të rrëgullohet nga institucionet duke e përkrah zhvillimin e ndonjë agjensionit që do ta bënte këtë punë për delegacionet që vizitojnë Prizrenin.

Z. A frim Rada – Partia Konservatore Prizren, shpalosi në pika të shkurtëra programin e partisë. Kjo parti e sheh kulturën si pasqyrë të identitetit kombëtarë gjatë historisë e cila rrit edhe reputacionin e vendit në arenën ndërkombëtare, kjo parti angazhohet për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kombëtare, diversiteti kulturor i vendit konsiderohet si një thesar i cili duhet të promovohet dhe të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet komuniteteve dhe shteteve ballkanike dhe evropiane. Kjo parti poashtu, angazhohet në depolitizimin e institucioneve kulturore, ruajtjen dhe promovimin e vlerave të mirëfillta kulturore, promovimin e dialogut ndërkulturor, ndëretnik dhe ndërkombëtarë. Sipas Z. Rada, partia Konservatore në programin e saj në fushën e kulturës ka përfshirë edhe qytetarët edhe organizatat e shoqërisë civile në jëtën institucionale dhe do të angazhohet për transparencë dhe llogaridhënie.

Z. Mensur Bytyqi – AAK, si përgjigje ndaj komentit të Z. Çeku për mos përfshirjen e shoqërisë civile gjegjësisht të organizatave të kulturës së pavarur në hartimin e politikave kulturore publike, ai lexoi disa pika të programit të partisë të cilën ai përfaqësonte e që ishin: ngritja e buxhetit, priorizimi i kulturës në politikat publike dhe decentralizimi i kulturës përmes partneriteteve me shoqërinë civile dhe me komunitetin artistik të Prizrenit. Sipas tij, deri sot kemi shumë dëshmi që në qytet ka njerëz të vullnetit të mirë që kanë guxim dijnë dhe organizojnë gjëra të mira mirëpo atyre duhet tu jipet hapësirë për këto sepse është e kotë nëse këtë pikpamje e kemi vetëm në fletore e në fund nuk realizohet asgjë.

Z. Besar Haxhibeqiri – Rrok, ishte i mendimit se një strategji kulturore është mjaft shumë e rëndësishme dhe kjo do ti ndihmonte jo vetëm kulturës dhe organizatave kulturore por edhe partive politike të cilat përmes kësaj strategjie të krijojnë politikat dhe prioritetet e tyre. Ai bëri të ditur se hartimi i strategjisë kulturore për qytetin e Prizrenit është njëra ndër synimet kryesore të Rrok-ut të cilën ata shpresojnë ta hartojnë në bashkëpunim me institucionet lokale.

Z. Çeku bëri një ndërhyrje të vogël ku theksoi se qytetit i mungojnë edhe shumë dokumente tjera përpos strategjisë së kulturës, mirëpo sipas tij kjo strategji duhet të shihet si një udhërrëfyes për hartimin e politikave kulturore publike si dhe dokumenteve tjera bazë që mungojnë në fushën e kulturës.

Z. Blerim Bytyqi, mori fjalën për t'ju drejtuar përfaqësuesve të partive politike prezen në debat më një pyetjen se cila prej këtyre partive politike do të ishte e gatshme ta fuste në listën buxhetore orkestrën e qytetit të cilën ai përfaqëson, ngase sipas tij deri tani nuk ka pasur mendime pozitive që kjo orkestër ia vlen të futet në listën e pagave?

Z. Hasan Hoti – Instituti për mbrojtjen e monumenteve në Prizren, ishte i mendimit se në programet e prezentuara nga partitë politike gjërat ishin shumë të përgjithësuara dhe se ato nuk kishin asnjë plan konkret për zhvillimin e kulturës në qytet dhe se ishte vetëm një kërkesë deri tani; ajo e buxhetit dhe parave. Në këtë pikë ai u ndërlidh me mënyrën e zhvillimit në shtetet perëndimore ku nuk ka ministri të kulturës por e kanë buxhetin e ndarë për kulturë, ai poshtu theksoi se buxheti nuk është faktori vendimtar në zhvillimin e kulturës duke përmendur shumë aktivitete të organizuara nga qytetarët në kohën e para luftës/okupimit. Sipas tij, vullneti i mirë i qytetarëve është më i vlefshëm dhe i dobishëm për zhvillimin e kulturës dhe e tejkalon mungesën e pjesës materiale, duke potencuar se zhvillimi i kulturës varet prej vetë qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Ai përfundoi duke shprehur gadishmërinë e institucionit të cilit përfaqëson, për përfshirjen dhe bashkëpunimin në hartimin e strategjisë kulturore për ngritjen e nivelit kulturor e turistik të qytetit të Prizrenit.

Z. Valon Xhabali – EC Ma Ndryhse, ju drejtua përfaqësuesve të partive politike me pyetjen se sa partitë politike i kanë përdorur të dhënat, hulumtimet apo edhe njoftimet e bëra nga organizatat e ndryshme jo- qeveritare dhe sa kanë qenë të gatshëm me e ftu një ose disa organizata kur e kanë hartuar planprogramin politik të tyre?

Z. Arbër Rexha, në përgjigje të pyetjes së shtruar nga **Z. Xhabali**, tha se gjatë fjalimit të tij ai kishte inkorporuar disa pjesë nga hulumtimet e organizatës EC Ma Ndryshe duke i thënë se para se të flistë është më mirë të gjykonte se të paragjykonte. Ndërsa në përgjigje të komentit të Z. Hotit sa i përket mos shpalosjes së planprogramit politik, ai i tha se në debate nuk është e natyrshme të bëhet shpalosje e planprogramit pasi që ajo do të merrte dy orë dhe i ftoi të gjitha ata që dëshirojnë të dijnë programin e Lëvizjes Vetëvendosje të marrin pjesë në tubimet kur lëvizja bën shpalosjen e programit të saj e në veçanti për fushën e kulturës.

Z. Çeku bëri një intervenim sa i përket pyetjes së Z. Xhabali duke theksuar se pyetja ishte se a ishin marrë parasysh hulumtimet dhe sa, dhe se pyetja nuk ishte sugjестive e as paragjykim.

Z. Qazim Thaqi, ishte i mendimit se mungesa e krerëve të partive politike duke e përjashtuar Z. Arbër Rexhajn, e bën shumë problematike të jenë të qarta projektet se cfarë bëjnë partitë e tyre për kulturën. Ai u ofroi ndihmë dhe bashkëpunim organizatave të shoqërisë civile që të hartojnë një strategji për kulturën me kusht që të rikthehet jeta kulturore të 72 shoqërive kulturo-artistike dhe të bëjnë dicka të mirë për qytetin.

Z. Çeku, duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme strategjinë për kulturën, foli për një dokument që ka kaluar nga kuvendi komunal para disa kohe e cila quhet strategji por që nuk ka kurfarë planifikimi ose strategjie në te. Sipas tij, edhe drejtoria e Turizmit ka filluar të hartoj një strategji si një lloj paralelizmi e që ne mendojmë që këto dy strategji duhet të jenë të kordinuara dhe integruara mes veti. Dhe se shpresat janë që shoqëria civile në bashkëpunim me mediat dhe komunitetin e biznesit mund të ofrojnë një alternativë të tyren për zhvillimin e qytetit dhe ta rikthejnë historinë që kishte qyteti.

Z. Veton Nurkollari – DokuFest, theksoi kështu ,“edhe pse shumë debate organizohen për kulturën, unë asnjëher nuk e kam parë prezent drejtorin e kulturës, e kjo mjafton me e pa se ky pushtet nuk mërëzitet shumë për kulturën edhe pse në rëtorikën e saj tregon për potencialin kulturor që e ka Prizreni dhe sa i jashtëzakonshëm është, edhe ky moment tash është një dëshmi që pushteti nuk ka strategji dhe nuk ka plan të bëjë një të tillë.” Iniciativën e Rrok-ut (Rrjeti i organizatave Kulturore) e vlerësoi si shumë të qëlluar dhe ndoshta e vetmja iniciativë prej ku mund të zhvillohet kultura në të ardhmen duke shtuar që ishte i zhgënjyer edhe me atë cka thanë dhe nuk thanë ngase panelistët përvec Arbrit, që sipas tij as ata nuk kanë ndonjë vizion se si duhet të zhvillohet kultura në këtë qytet. Ai tha se Prizreni ka shumë potencial dhe ka nevojë për një vizion të mirëfilltë ku inkorporohen njerëzit me dijeni në këtë fushë të cilët dijnë ta qojnë kulturën përpara. Ai përfundoi duke cekur se e gjitha puna e bërë nga EC Ma Ndryshe deri tani dhe iniciativa e Rrok-ut janë një hap shumë i madh se si duhet të zhvillohet kultura në qytet.

Z. Afrim Rada, në përgjigje të pyetjes së Z. Xhabali “sa partitë politike i kanë përdorur të dhënat, hulumtimet apo edhe njoftimet e bëra nga organizatat e ndryshme jo- qeveritare dhe sa a kanë qenë të gatshëm me e ftu një ose disa organizata kur e kanë hartuar planprogramin politik të tyre,” tha se në fillim të fjalimit të tij kishte cekur që pasi kultura paraqet pasqyrën e identitetit kombëtar dhe duke qenë

pjesë e qytetit ata i kanë kushtuar rëndësi zgjedhjes së problemeve me faktin që ata synojnë në promovimin dhe mbrojtjen e vlerave kulturore të Prizrenit pasi që qyteti më nuk i ka vlerat që i ka pasur dikur.

Z. Mensur Bytyqi, në përgjigje të pyetjes se si drejtoria e kulturës të jetë një prej drejtorive më të rëndësishme në komunë e jo si një rezultat i pazareve politike sic ka qenë deri tani, tha se është fat i mirë që ka opozitë jo partiake por opozitë të OJQ-ve. Poashtu në përgjigje të komenteve të Z. Hoti dhe Z. Qazim Thaqi për aktivitetet e organizuara para luftës tha se në atë kohë të gjithë qytetarët kanë qenë aktiv ndërsa tash kemi një dëshprim masiv të popullatës dhe nuk janë aktiv si më parë. Ai poashtu ceki së ka qenë dhe është kundërshtar i procesit të emërimeve politike të njerëzve jo profesional në poste të caktuara ngase ajo është degradim i synimeve fillestare. Në të njëjtën kohë ai shtoi se e tërë esenca e zhvillimit të kulturës nuk qëndron te pushteti i caktuar por te vulneti i përgjithshëm i njerëzve që duan ta shohin kulturën në vecanti dhe qytetin në përgjithësi më të zhvilluar.

Z. Arbër Rexhaj – shprehi keqardhje për faktin se sipas tij dëgjon abstraksione nga përfaqësues të partive se ata do t'u lëshojnë vend të rinjëve ose fjalë të të ngjashme që janë retorikë boshe e nuk japin përgjigje të drejtpërdrejtë. Ai vazhdoi duke thënë se Lëvizja Vetëvendosje edhe pse shumë shpesh etiketohet me një lëvizje që nuk bën asgjë tjetër vetëm fol për bashkim ose organizon protesta dhe nuk ka plane konkrete për zhvillim ekonomike ose procese tjera shoqërore une mund të them se nëse kjo lëvizje në të ardhmën do të ishte në pushtet në Prizren do ta mirrte dhe ta udhëhiqte drejtorinë e kulturës.

Z. Afrim Tejceci, ishte i mendimit se kur komuna e Prizrenit nuk zotohet të jap 2500 euro për funksionalizimin e Art Qendrës atëherë qyteti i Prizrenit e ka të pamundur të aplikoj për fonde të Bashkimit Evropian për ndonjë projekt tjetër.

Z. Afrim Rada, që drejtoria e kulturës të jetë e suksesshme fillimisht duhet të bëhet depolitizimi i kulturës në dy segmente; 1) duke i ndarë një buxhet shumë më të madh, kjo duke u nisur prej faktit se nëse udhëhiqet nga partia në pushtet atëherë ka buxhet më të madh dhe shumë privilegje dhe nëse udhëhiqet nga një parti në opozitë atëherë nuk ka buxhet e as privilegje, dhe 2) depolitizimi kërkohet sepse, kështu si është, financimi i projekteve bëhet në nivel partiak, ndërsa me depolitizim të drejtorisë do të përfitonte qyteti i Prizrenit në të gjitha aspektet.

Z. Arbër Rexhaj, në përgjigje të Z. Blerim Bytyqi për përfshirjen e orkestrës së qytetit në listën buxhetore, tha se lëvizja të cilën ai përfaqëson ka për qëllim të krijoj kushtet për zhvillimin e këtyre shoqërive e në alternativën tonë qeverisëse ju mund të shihni ekzakt se si do ti ndihmojmë financiarisht por edhe me udhërrëfyes këto asociacione.

Z. Hasan Hoti, tha se është shumë e rëndësishme që për fushën e kulturës të gjitha partitë ta kenë një qasje dhe të bashkëpunojnë njëra me tjetrën dhe nuk është e rëndësishme se sa faqe përmban programi partiak i njëjës parti ose tjetrës.

Z. Çeku – përmbylli debatin duke i falenderuar pjesëmarrësit dhe duke i informuar ata se në fund të muajit Maj ose në fillim të muajit Qershor do ta kenë gati publikimin i cili do të përfshijë të gjitha të gjeturat e hulumtimeve, diskutimet e serisë së debateve që janë zhvilluar në kuadër të këtij projekti dhe do të jetë një udhëzues për partitë politike që ndoshta do të vazhdojnë të ndërtojnë planprogramet e

tyre duke u bazuar në rekomandimet e kulturës së pavarur. Sipas tij, ishte për kecardhje që një subjekt politik si Partisa Demokratike që është udhëheqëse e komunës të mos dërgojë një përfaqësues të tyre në debat, e kjo konsiderohet si një distancim i pakuptimtë nga debati dhe nuk mund të arsyetohet.

**PYETËSORI PËR HULUMTIMIN MBI EKSPOZIMIN NË AKTIVITETE KULTURORE DHE PJESËMARRJEN
QYTETARE NË ZHVILLIMIN E POLITIKAVE KULTURORE**

INTERVISTUESI: JU LUTEM KOMPLETONI KËTO PYETJE ADMINISTRATIVE PARA SE TË VAZHDONI ME INTERVISTËN

R1 – Numri i respondentit: _____

R2 – Kodi i intervistuesit: _____

R3 – Data e intervistës: _____

R4 – Koha e fillimit të intervistës: _____; Koha e përfundimit të intervistës: _____

INTERVISTA FILLON me prezntimin e mëposhtëm:

Përsëndetje, unë quhem _____. Unë punoj për organizatën EC MA NDRYSHE. Ne jemi duke implementuar një hulumtim në mënyrë që të kuptojmë më shumë për mendimet dhe qëndrimet e juaja për jetën kulturore në qytetin e Prizrenit.

Mënyra se si e zgjedhim respondentin është e rastësishme prandaj ju lusim të na tregoni se kush nga anëtarët e familjes që i ka 16 vjet e më shumë e ka ditëlindjen në muajn JANAR ose më afër muajit JANAR.

Unë nuk do të marr shënime për emrin tuaj apo adresën pra iu siguroj se pergjigjet e tua nuk do te jene te lidhura me ate se kush jeni ju, dmth keto pergjigje mbesin pa emer dhe jane te fshehta. Ju keni të drejtën të ndalni intervistën në çfarëdo kohe. Pjesëmarrja juaj është komplet vullnetare por përvoja juaj mund të jetë shumë e rëndësishme për kulturen në VEND.

A keni ndonjë pyetje? (Intervista merr përafërsish 15 minuta për tu kompletuar). A pajtoheni të intervistoheni?

SHËNO NËSE RESPONENTI PAJTOHET APO JO TË INTERVISTOHET

[] NUK PAJTOHET TË INTERVISTOHET, FALENDERO PJESËMARRSIN PËR KOHËN DHE PËRFUNDONI

[] PAJTOHET TË INTERVISTOHET. A është tash kohë e përshtatshme për të biseduar?

A është ky një vend i mirë për të realizuar intervistën, apo a ka ndonjë vend tjetër ku ju do të dëshironit të shkonim?

TË KOMPLETOHET NGA INTERVISTUESI:

Unë vërtetoj se e kam lexuar procedurën e pëlqimit të pjesëmarrësit.

Nënshkrimi: _____

Të dhënat demografike

D1. Kur keni lindur? Muaji: _____ Viti: _____

D2. Kjo do të thotë se ju i keni _____ vjet [SHKRUANI MOSHËN ME NUMRA].Gjinia:

D3. Mashkull 1 Femër 2

D4. Cili prej përshkrimeve në vijim ju përshtatet më së shumti?

A. Mbi të gjitha jam shqiptar i Kosovës	1
B. Mbi të gjitha jam serb Kosovës	2
C. Mbi të gjitha jam turk i Kosovës	3
D. Mbi të gjitha, i takoj komunitetit RAE në Kosovë	4
E. Mbi të gjitha jam Bosnjak i Kosovës	5
F. Jam nënshkruar i huaj në këtë vend	6
G. tjetër: të lutem përshkruaje: _____ [SHËNO]	7

D5. Cili është niveli më i lartë i shkollimit që e keni arritur? [zgjedh vetëm një përgjigje]

Nuk ka vijuar shkollën	1
Nuk ka mbaruar shkollën fillore	2
Ka mbaruar shkollën fillore	3
Nuk ka mbaruar shkollën e mesme	4
Ka mbaruar shkollën e mesme	5
Ka filluar por nuk ka mbaruar studimet universitare	6
Ka mbaruar studimet universitare	7

D6. A i takoni ndonjë feje apo kategorie fetare? Nëse po, cilës?

[SHËNONI NJË PËRGJIGJE]

Katolik	1
Protestant	2
Ortodoks	3
Hebrej	4
Musliman	5
Hindu	6
Budist	7
Bektashinjë	8
Tjetër [SHËNO]: _____	9
Nuk i takoj asnjë kategorie fetare	0

D7. Pavarësisht nëse i takon ndonjë feje apo kategorie fetare, a mund të thoni se jeni...?

[LEXONI DHE SHËNONI NJË PËRGJIGJE]

Person fetar	1
Person jo fetar	2
Ateist	3

D8. Cili është statusi juaj martesor AKTUALISHT?

- A) Beqare 1
 B) Jam në lidhje (kaloj) 2
 C) i/e fejuar 3
 D) i/e Martuar 4
 E) i/e Ve 5
 F) i/e ndarë 6

D9. Kush e përbën familjen tuaj? Ndoshta ma sakte eshte me pyte “me cilët anëtarë të familjes banoni?

- A) Familja e ngushtë (prindërit, vëllezërit, motrat) 1
 B) Familja ime e gjerë (prindërit, vëllezërit, motrat, axhallarët, gjyshi, gjyshja) 2
 C) Familja e ngushtë martesore (burri/gruaja dhe/ose fëmijët) 3
 D) Familja e gjerë e burrit (vjeherri, vjehrra, kunati, kunata, etj.) 4
 E) Partneri (bashkëjetesë) 5
 F) E vetme 6
 G) Të tjerë _____ 7

D10. Sa anëtarë të familjes jetoni në shtëpi aktualisht? _____**D. 11 Çka punoni?**

- A) Punë jashtë shtëpisë (punë me rrogë) 1
 B) Merrem me bujqësi 2
 D) Punon kohë pas kohe 4
 E) Mumentalisht i/e papunë, por duke kërkuar punë 5
 F) i/e papunë, nuk kërkon punë 6
 G) Ende student 7
 I) i/e pensionuar 8
 J) i/e paaftë për punë 9

D12. Sa është vlera e pagës suaj? [NËSE JENI DUKE PUNUAR]

- A) 0 – 100 euro 1
 B) 100 – 250 euro 2
 C) 250 – 500 euro 3
 D) Më shumë se 500 euro 4
 E) Më shumë se 1000 euro 5
 D) Refuzon të përgjigjet 6

D13. [TREGONI KARTËN E, E CILA PËRMBAN GRUPET E TË ARDHURAVE TË DEFINUARA NË DECILE]

Në këtë kartë është shkalla e të ardhurave ku 1 paraqet grupin me të ardhura më të ulëta dhe 10 paraqet grupin me të ardhurat më të larta në vendin tuaj. Ne dëshirojmë të dimë në cilin grup bën pjesë familja juaj. Ju lutem, shënoni numrin adekuat, duke llogaritur të gjitha pagat, rrogat, pensionet apo të ardhurat tjera që i keni.

[VINI RE, GRUPET DUHET TË SHËNOHEN PREJ NJË DERI MË DHJETË– MUND TË JA SHPJEGONI KËTË RESPONDENTIT NËSE ËSHTË E NEVOJSHME]

[SHËNONI NJË NUMËR]

Decili më i ulët									Decili më i lartë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

D 14. A jeni ju ose dikush tjetër në ekonominë tuaj familjare që jeton këtu pronar të biznesit privat?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon
4. Nuk e di

(Perceptimi mbi ndikimin e organizatave në shoqëri)

P15. Gjatë pesë (5) viteve të fundit, a ka pasur ndonjë ndikim pozitiv ose a keni dëgjuar për ndonjë ndikim pozitiv të organizatave të mëposhtme, në rrethin ku ju jetoni:

[SHËNONI TË GJITHA PËRGJIGJET ‘PO’ ME 1; NËSE NUK PËRMENDEN SHËNONI ME 2]

		Ka pasur ndikim pozitiv	Nuk ka pasur ndikim pozitiv
15.1	Organizatë e artit, muzikës apo arsimit	1	2
15.2	Sindikata e Punës	1	2
15.3	Organizatë mjedisore	1	2
15.4	Shoqatë profesionale	1	2
15.5	Organizatë humanitare apo bamirëse	1	2
15.6	Organizatë rinore	1	2
15.7	Organizatë për të drejtat e njeriut	1	2
15.8	Organizatë për avokim dhe demokratizim	1	2
15.9	Tjetër [SHËNONI]: _____	1	2

(Koha e lirë)

K16. Do t'ju pyes sa shpesh merreni me aktivitetet e mëposhtme. Për çdo aktivitet, a mendoni se e bëni çdo javë apo përafësisht çdo javë; një herë apo dy herë në muaj; vetëm disa herë gjatë vitit; apo asnjëherë?

		Çdo javë/ përafësisht çdo javë	Një apo dy herë në muaj	Vetëm disa herë në vit	Asnjëherë
16.1	Kaloni kohë me prindër apo të afërm tjerë (kush janë te afermit tjerë)	1	2	3	4
16.2	Kaloni kohë me miq	1	2	3	4
16.3	Kaloni kohë me kolegë të punës apo të profesionit	1	2	3	4
16.4	Kaloni kohë me njerëz në xhaminë, apo kishën tuaj	1	2	3	4
16.5	Kaloni kohë me njerëz në klube sportive apo në organizata vullnetare apo organizata të shërbimit	1	2	3	4

(Marrja me aktivitet kulturore në vetën e parë - sjellje)

Pyetjet e mëposhtme ju lusim t'i përgjigjeni me mundësitë që do të ju lexoj:

17. Çka është sendi i parë që ju bjen në mend kur përmendet kultura? (shëno ato që i përmend respondentit): _____

17.1 Shkruani (poezi, prozë etj.)	Jo nuk shkruaj dhe nuk kam shkruar	Kam shkruar më herët	Shkruaj	Tjetër:
17.2 I bjen ndonjë instrumenti muzikor	Jo nuk i bie dhe nuk i kam rënë	I kam rënë më herët	Ende i "bie" ndonjë instrumenti	
17.3 Jeni pjesëtarë të ndonjë shoqërie kulturo-artistike (kor, ansambël, teatër, OJQ etj.)	Jo nuk jam dhe as që kam qenë	Kam qenë më herët	Jam anëtarë aktiv	Tjetër:

18. Pyetni respondentin si vijon: “A mirreni me ndonjë aktivitet tjetër kulturor që nuk kam përmendur?”

PO

JO

Nëse PO specifiko cka? _____

19. Sa shpesh e përdorni internetin për argëtim apo për të kaluar kohën e lirë (jo për punë)?

Çdo ditë Disa herë në javë Një herë në javë 1 deri 3 herë në muaj shumë

Rrallë Asnjëherë

20. Pyetjet e mëposhtme kanë të bëjnë me 12 muaj e fundit (gjatë vitit 2012) ju lus t’i përgjigjeni me PO ose JO pyetjeve që do të ju bejë

20.1 Keni blerë libër (përfshirë tekstet obligative shkollore)?

PO

JO

20.1.1 Nëse PO sa libra përafërsisht? _____

20.2 Keni blerë filma apo programe argëtuese?

PO

JO

20.2.1 Nëse PO sa filma apo programe argëtuese përafërsisht? _____

20.3 Keni blerë CD të muzikës?

PO

JO

20.3.1 Nëse PO sa CD përafërsisht? _____

21. Pyetni nëse respondent ka shkarkuar nga interneti filma, libra apo muzikë nëse? PO JO

21.1 Nëse PO cka rrumbullakso (edhe nëse është më shumë se një opcion)?

☐ Muzikë

☐ Filma

☐ Libra

(sjellje në lidhje me pjesëmarrjet në aktivitete kulturore)

S22. Përsëri në 12 muajt e fundit apo gjatë vitit 2012 a ju ka ndodhur që të vizitoni/merrni pjesë/shkoni në qytetin e Prizrenit në këto aktivitete që do ti përmendi më poshtë (nëse respondentit nuk i kujtohet ngjarja atëherë ajo do të konsiderohet se ka marrë pjesë po nuk i kujtohet konkretisht çka) :

		Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
22.1 Shfaqje teatrale	PO	
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Nuk kam informatë se kur ka shfaqje
22.2 Koncert të muzikës klasike	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Nuk kam informatë se kur ka koncert
22.3 Koncert të muzikës zbavitëse (me pagesë)	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka koncert
22.4 Koncert të muzikës popullore (me pagesë)	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa

		G) Nuk kam informatë se kur ka koncert
22.5 Kinema	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka koncert
22.6 Festival të filmit	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka festival
22.7 Festival të muzikës argëtuese	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka festival
22.8 Festival të muzikës popullore	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë

		E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka festival
22.9 Festival të pikturës apo skulpturës.	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka festival
22.10 Bibliotekë	PO	Cilën bibliotekë?
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se ku janë bibliotekat
22.11 Ekspozitë të fotografisë	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka ekspozite
22.12 Ekspozitë të pikturës	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë

		B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka ekspozite
22.13Takime letrare	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur mbahen takimet letrare
22.14Përkujtime për dëshmore dhe përvejtore nga lufta e fundit në Kosovë	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur mbahen ato
22.15Koncerte në lokale	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se ku mund të blejë libra

22.16 Lexuar libër	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka koncert
22. 17 Shën Gjergj	PO	
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa
22. 18 Koncerte në sheshe të hapura për publikun	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka koncert
22. 19 Vizitë në muzetë e qytetit (Lidhja e Prizrenit, Muzeu në Sahatë Kullë)	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se ku janë

22.20 Vizitë në lokacione arkeologjike (Kalaja qytetit etj.)	PO	Nëse po a ju kujtohet cila/t? shëno:	
	JO	A) Është vështirë të gjej kohë B) Nuk më ka shkuar në mend C) Nuk jam i/e interesuar D) Nuk kam nevojë E) Nuk ka shpesh F) Vështirësi në financa G) Nuk kam informatë se kur ka koncert	
22.21 Tjetër shëno: _____	PO	JO	

23. A keni qenë në ndonjërin nga aktivitetet e Dokufestit?

PO (nëse PO shko në pyetjen 23.1)

JO (nëse jo shkon në pyetjen 23.2)

23.1 Nëse PO cilët nga këto aktivitete i keni vizituar (rrumbullakso nëse përmend më shumë se 2, në hapësirën pas zgjidhjes shëno një cilën e viziton më shumti dhe me dy tjetërën me rradhë):

- A) Filmat _____
B) Dokunight _____
C) Dokukids _____
E) DokuPhoto _____
F) Debatet dhe panelet _____
F) Tjetër shëno: _____

23.2 Nëse JO cila është arsyeja kryesore që nuk shkoni:

- A) Është vështirë të gjej kohë
B) Nuk më ka shkuar në mend
C) Nuk jam i/e interesuar
D) Nuk kam nevojë
E) Nuk është në përputhje me shijet e mia
F) Vështirësi në financa
G) Tjetër shëno: _____

Perceptime

24. A mendoni se ka aktivitete të mjaftueshme kulturore në qytetin e Prizrenit?

Ka më shumë aktivitete se qytet e tjera	Deri diku ka më shumë aktivitete se qytetet e tjera	Ka më pak aktivitete kulturore se qytetet e tjera	Ka shumë më pak aktivitete kulturore se qytetet e tjera	Nuk e di
---	--	--	--	----------

25. Sa jeni të kënaqur me aktivitet kultore në qytetin e Prizrenit?

1 2 3 4 5 6 7 8

Aspak të kënaqur

Shumë të kënaqur

Qëndimet – Më poshtë janë disa fjali apo konstatime të shtruara nga ju kërkojmë që të deklaroheni me atë se pajtoheni apo nuk pajtoheni me deklaratat e mëposhtme:

26. Kultura dhe jeta kulturore në jetën time personale është?

- a) Aspak e rëndësishme
- b) Jo aq e rëndësishme
- c) Mesatarisht e rëndësishme
- d) Shumë e rëndësishme

27. Cila nga faktorët e mëposhtme ndikon në vendimin tuaj për të marrë pjesë apo jo në një aktivitet kulturor? (zgjedh deri në dy opsione)

- a) Të jetë e argëtueshme
- b) Të kënaqem me familjen apo shoqërinë
- c) Të jem në gjendje të mbulojë financiarisht shpenzimet e aktivitetit
- d) Të jetë interesante
- e) Të jetë relaksuese
- f) Të kem qasje të lehtë për të shkuar deri te vendi edhe kthyer
- g) Të jetë në përputhje me vlera e mia tradicionale
- h) Të jetë educative

28. Nga cili burim informoheni më së shumti mbi aktivitetet kulturore në qytetin e Prizrenit?

- a) Nga miqtë dhe të afërmit
- b) Televizioni
- c) Radio
- d) Gazetat dhe shtypi ditor
- e) Nga broshurat dhe posterat në qytet
- f) Ëeb faqet e organizatave kulturore
- g) Facebook
- h) Tjetër shëno: _____

29. Cila nga arsyet e mëposhtme vlen për juve si faktorë që ndikon në mospjesëmarrje në aktivitetet kulturore në qytetin e Prizrenit?

- a) Nuk kam kohë
- b) Janë të shtrenjta
- c) Nuk kam interesim
- d) Nuk kam informatë se cka është duke ndodhur
- e) Nuk ka kualitet në jetën kulturore
- f) Nuk kam dijeni nuk kam prapavijë kulturore
- g) Nuk përshtaten me besimet/vlerat dhe zakonet e mia

Tjetër shëno: _____

30. Qëndrime – më poshtë janë dhënë disa deklaratat qëndrime ju lusim të na tregoni se sa fuqimisht pajtoheni, pajtoheni, nuk pajtoheni dhe fuqimisht nuk pajtoheni me këto deklarime

Dekleratat	Fuqimisht pajtohem	Pajtohem	Nuk pajtohem	Fuqimisht nuk pajtohem
30.1 Të gjithë fëmijët në shkollë duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në aktivitete kulturore.	4	3	2	1
30.2 Të gjithë fëmijët në shkollë duhet të kenë mundësi të mirren me aktivitete artistike.	4	3	2	1
30.3 Pjesëmarrja në aktivitete artistike e bën personin të ndihet më mirë për veten e vetë.	4	3	2	1
30.4 Në aktivitete artistike në galeri, teatër, muze ndihem pak si i/e humbur.	4	3	2	1
30.5 Fondet publike duhet të shpenzohen për aktivitete artistike.	4	3	2	1
30.6 Aktivitetet artistike e bëjnë Prizrenin vend më atraktiv.	4	3	2	1
30.7 Nëse humbet kultura lokale atëherë humbasin edhe njerëzit që jetojnë në atë mjedis.	4	3	2	1
30.8 Arti dhe kultura pasurojnë jetën e një personi.	4	3	2	1
30.9 Arti dhe kultura ndihmojnë turizimin e qytetit të Prizrenit	4	3	2	1
30.10 Komuna duhet shpenzojë më shumë mjete në aktivitete kulturore	4	3	2	1
30.11 Aktivitetet kulturore e crregullojnë qetësinë e qytetit.	4	3	2	1
30.12 Ardhja e të huajve gjatë ngjarjeve kulturore në qytet më pengon.	4	3	2	1
30.13 Unë jam i interesuar për kultura të shteteve të tjera.	4	3	2	1

31. Renditni (rankoni) katër aktivitete apo fusha të cilat do të dëshironit të keni në komunën tuaj (lista i jipet respondentit)

Kinema që punon cdo ditë_____

Shfaqje të përditshme të teatrit_____

Shfaqje të shpeshta për fëmijë_____

Më shume festival të ndryshme_____

Më shumë koncerte me muzikë klasike_____

Më shumë koncertë me muzikë zbavitëse_____

Më shumë koncertë me muzikë popullore_____


Më shumë ekspozita të fotografisë_____

Më shumë ekspozita të pikturës_____

Më shumë ekspozita të skulpturës_____

Tjetër shëno:_____

Për fund a mund të jë marrim një numër të kontaktit për të kontrolluar nga mbikëqyrësit tonë nëse ne e kemi bërë në rregull anketimin:_____



Swiss Cooperation Office Kosovo

“This project/activity is funded by Democratic Society Promotion (DSP) project - financed by Swiss Cooperation Office Kosovo (SCO-K) and managed by Kosovar Civil Society Foundation (KCSF)”

“This publication has been produced with the support of Democratic Society Promotion (DSP) project - financed by Swiss Cooperation Office Kosovo (SCO-K) and managed by Kosovar Civil Society Foundation (KCSF). The contents of this publication are the sole responsibility of Non - Governmental Organization Emancipimi Civil Ma Ndryshe and can in no way be taken to reflect the views of SCO-K or KCSF.”

Study on the views,
behaviours and perceptions
of the citizens of Prizren on
the culture and art – a legitimate
basis for devising cultural policies in Prizren

Author: Aliriza Arënliu
Organisa on: EC Ma Ndryshe
April 2013

Contents

Introduction	3
Background	3
Management structure of culture in Prizren	4
Independent cultural sector in Prizren	4
Other relevant documents.....	4
The study on views, behaviours and perceptions of the citizens of Prizren on culture and art	4
Sample selection	4
Description of the sample	4
It a	8
A survey with cultural organizations in Prizren	12
Outcomes	12
Human resources in organizations	12
Logistics and the infrastructure of organizations.....	13
Organized activities, funding and participation in local cultural policy processes.....	14
Summary from public discussions.....	16
Conclusions and discussion.....	17
For the first time c.....	18
Deliberation	19
Limitations of the study	21

Introduction

This survey consist of the study report (research) conducted by NGO EC Ma Ndryshe with 500 citizens/inhabitants of the city of Prizren and the results of 23 structured interviews with organizations involved in cultural activities in Prizren, and the summary of four various discussions held with relevant stakeholders in the field of culture and cultural heritage. This report particularly aims to analyze the data from these three sources of data and finally to try draw up conclusions and to provide recommendations for the next steps in the field of culture in Prizren. The purpose of this paper is also to try and present basic guidelines for the development of cultural policies in the city, based on the data and the outcomes of this research. This is the first attempt of its kind that uses a comprehensive method of data collection for culture and issues related to cultural sector in the city of Prizren.

Background

